

814-32
—
F84.

Thomas Frashëri

RIMAT NUK VDESİN

(Tregime)

814-32
F84

THOMA FRASHËRI

TRIMAT NUK VDESIN

(TREGIME)



N. SH. BOTIMEVE «NAIM FRASHËR»
TIRANË, 1962

TRIMAT NUK VDESIN

Kur erdhi në brigadë nuk tha vëç tri fjalë:

— Dua të vras gjermanë!

Vullnetari i ri rrinte mënjanë, vështronët
vjetdhurazi armët e shokëve dhe herë pas here
shtërgonte nagaçen e varur në brez.

— E me se do t'i vrasësh? — e ngacmoi një-
ri.

— Hëpërhë me këtë nagaçe.

Partizani u shkeli synë shokëve dhë vijoi:

— I ke parë ndonjëherë miqtë? Po krismën
e sharseve¹⁾ të tyre ta ka zënë veshi?

Vullnetari u skuq dhe nuk u përgjegj për
disa çaste; pastaj, si t'ish kujtar për diçka, u
vrejt, vuri dorën te nagaçja dhe foli:

— Le të jenë si të duan!

Zëri i tij qe i egër, kanosës. Partizanët vësh-
truan njeri-jatrin, ngritën supet dhe s'e trazuan
më.

U caktua në kompaninë e dytë. E quanin Nu-
re. Mund të qe nja tetëmbëdhjetë vjeç. Me trup
vinte i lidhur mirë, fytyrën e kish të hequr dhe
muskujt e nofullave të ndera. Të mos qenë sytë

1) Shars = kështu i quanin partizanët mitrolozët e
lehtë gjermanë.

e tij, që tē bënин pér vehte, zor ta dallonje nga tē tjerët. I kish tē mëdhenj, me ngjyrë herë si ujët e detit, herë si qelli i kulluar. Ta kish énda t'i vërenje m'u në bebëza ata sy, që shihnin émbël e që kishin pérherë një hije trishtimi.

Zunë ta thërrisinin «Memec». Këtë nofkë ia ngjiti Tasja, korieri i kompanisë, që s'linte njeri pa ngacmuar dhe pa i vënë ndonjë emër dallojnës. Po Nurja as u nxit as u prek. Tërë ditën e kalonte mënjanë me nagaçen e tij.

— O është shumë i mënçur ose nuk i ka në rregull «vidhat» — nisi tē filozofojë korieri. — Nejse, lufta do ta tregojë më mirë.

Lufta s'mënoi. Kompanija i ngriti pritë një autokolone armike. Tasja zuri vend enkas pranë «Memecit» dhe or'e çast e vërente me bisht të syrit. Nurja rrinte në pozicion pa lëvizur, me sytë myllur përgjysmë sikur flinte.

— Me sa duket, zor tē çkulet nga gropa kur tē hidhemi në sulm, — fliste korieri me vete.

Po kur u dha shenja e sulmit Tasja s'e pa më pranë, as rrotull. Ai u çduk si era. E diktoi më vonë, pér një çast, tutje, matanë rrugës, nëpër ca ferra tek përleshej me një nazist. U turri në pikë tē vrapti t'i vinte ndihmë, po në ferrë nuk e gjeti më.

— Paska qenë me tē vërtetë i marrë. Shkoi si cjapi te kasapi — çfryu dhe, pér hesap tē tij, e hoqi nga defteri i tē gjallëve.

Përleshja mbaroi. Kompanija zuri tē ngjité malin përpjetë. Korieri kërkoi komisarin që t'i raportonte pér tē «marrin». Kur e pa mbeti gojë hapur. Komisari qe bashkë me «Memecin». Nurja qe shëndoshë si molla. Në krahë mbante dy ai-

tomatikë gjermanë e një palë dylbi të gjata. Në brez kish nagaçen.

— Djall' o punë! Ky i paskesh patur «vihat» në rregull! — mërmëriti korieri.

Në bazë u fol për trimërinë e Nures. Komandanti i dhuroi një nga automatikët dhe dylbitë.

Atë mbrëmje korieri iu afrua.

— Për besë, o Nure, sot në mëngjes të bëra të vdekur, — i tha.

Në vend që t'i përgjigjej, «Memeci» hoqi dylbitë nga qafa dhe ia dha Tases.

— Jo, s'kam s'i t'i marr. Ty t'i dhuruan për trimëri.

— S'prish punë. Ty të nevojiten më shumë.

Kaluan disa javë me luftë dhe marshime. Një ditë, gjatë përpjekjes, kompania e pati pisk. Armiqtë sulmonin të tërbuar. Donin të çanin shtegun, që e mbronte kompania, e t'u dilnin nga pas forcave të brigadës. Filloi përlleshja trup me trup. Forcat e kompanisë zunë të përqahen, partizanët po çkëputeshin nga njeri jatri. Asnjeri s'merrte vesh se ç'bëhej. Vetëm zëri i fuqishëm i komandantit, që urdhëroi të sulmonin përrpara e të dilnin te bregu përballë, i solli në vete. Duke hapur rrugën me granata partizanët dollën matanë dhe i detyruan armiqtë të kthehen prapa. Nga bregu, Tases i vanë sytë te një përrua. Vangjelia, e vëtmja shoqe e kompanisë, vraponë në anën e kundërt. E ndiqnin dy gjermanë.

— Bobo, do ta zenë të gjallë! — belbëzuan

nja dy partizanë pranë korierit dhe, bashkë me Tasen, filluan të qëllojnë armiqjtë.

— Mos shtini! — thirri «Memeci» dhe u hodh para me mitrolozin e lehtë në dorë. Vraponte dhe hapte zjarr. Kur iu afrua gjermanëve, u hodhi dy granada, kaptoi pérroin, ndërsa s'pushonte së dhëni zemër Vangjelisë që lark. E arri-
ti pa mitroloz, luftoi me nagaçen kundër një gjermani, që vijonte të ndiqte partizanen, pastaj u shemb përdhe nga lodhja dhe nga një plagë në këmbë. Pas tij u sulën partizanë të tjerë dhe i térhoqën të dy.

Tases më vonë, nuk iu ndejt pa iu afuar përséri «Memecit», si gjithnjë, për ta ngacmuar. E gjeti, me këmbë të lidhur, tek lexonte një broshürë të zhurbavitur të komisarit.

— Shiko, shiko, po u thelloke — foli korieri, po si nuk mori përgjigje ja nisi:

— Kam téré ditën që mendoj, Nure: si u fute fill i vetëm, thellë, në mes të gjermanëve? Apo se ishte Vangjelia dhe...

— Ndaj kam dalë partizan, — e ndërprenuria.

— Mirë, xhanëm; po ti i dolle vdekjes përballë. E mendove se mund të vdisnje?

Nurja tundi kryet ngadale e u përgjegj:

— Trimat nuk vdesin.

— È? —

— Kështu është, Tase, — foli gjene Nurja. — Plumbi ngjitet më lehtë në kurriz se në ballë.

— Tamam, fjalë me mend, — pëshpëriti korieri, si i mundur dhe vendosi të mos i bjerë më në qafë.

Dimri me cikna, dëborë dhe tufane erdhë papritur. Qe një dimër i egër. Forca të mëdha naziste, xhandërmarije dhe balliste u sulën nga të gjithë anët. Përleshjet qenë të ashpra. Partizanët, me nga një ballë fyshekë, luftonin me shpirë në dhëmbë, të nxirë e të buhavitur nga të ftohit, të pa ngrënët dhe pagjumësia. Shkurti e gjeti bataljonin të çkëputur nga brigada dhe, në javën e tretë të atij muaji, kompanija ndodhej fshehur në një pyll të dëndur, larg batalionit.

— Dy partizanë duhet të hidhen te mali karshi, — foli komisari i kompanisë një mëngjes.
 — Atje ndodhet shtabi i batalionit. Na duhet t'i njoftojmë ku jemi dhe nga cila anë do të çajmë rrëthimin. Ka ndonjë vullnetar që dëshëron të shkojë me Tasen?

Partizanët hodhën sytë nga mali. Nuk ishte punë e lehtë të kalonje përmes armiqëve, që kishin mbyllur çdo shteg, të kapërcenje lumin në atë të ftohtë, t'u qepeshe shkëmbijve të thepisur e të bridhje shpellë më shpellë gjersa të gjeje shtabin.

Ngriten dorën disa. Komandanti zuri t'i vërejë me kujdes dhe u mat të thërriste njerin, po në atë çast «Memeci», që rrinte mënjanë, vu-ri sharsin e tij në krahë dhe doli përpara shokëve.

— Dërgomëni mua! — i tha komandantit.

— Jo, — ia preu komandanti. — Javën e fundit ke bërë roje pér natë.

— Gjer më sot nuk ju jam lutur kurrë pér ndonjë send, — përsëriti gjene Nurja, duke iu drejtuar komisarit.

— Pse ngul këmbë? — e pyeti ky.
— Ashtu e kam punën. Kam gjak pér tē marrë.

Komisari ia nguli sytë dhe i tha:

— Të gjithë gjak kemi pér tē marrë.

Nurja heshti. Zuri tē kthehej në vendin e tij, por, si bëri dy hapa, ndërroi mendje dhe foli sërish, duke mbledhur duart grusht:

— Unë e kam ndryshe punën. Ju kini prin-dër, vëllezër, motra; mua m'i vranë.

Heshti një çast dhe pastaj shtoi, duke pshe-rëtirë:

— Shtinë mbi vëllanë dhe e mbuluan në gropë pa dhënë akoma shpir. Nënën e vranë tek ra përbys mbi të, që tē mos e mbulonte dheu, motrës... motrës ia dërmuan kryet me çizme...

Trupi filloj t'i dridhej si purtekë, sytë iu egér-suan.

— Dërgomëni mua, — u lut përsëri — Gjalë a vdekur do ta gjej shtabin.

— Mirë, — vendosi komisari, pasi pa komandan-tin. — Shko bashkë me Tasen dhe nesër mbrëma duhet tē jeni këtu medoemos e me letër nga shtabi, ndryshe nuk na gjeni më.

U nisën menjëherë.

— Një amanet, o shokë, — u tha Tasja tek largohej. — Në mos u kthefshim, mos na harroni dhe, po tē doni, merrjani ndonjëherë pér Nuren këngës së Flamurit tē Kuq.

— Do ktheheni shokë, dhe këngën do ta këndojmë bashkë. Fol o Nure!

Nurja vuri buzën në gaz.

Atë ditë, nga larg, u ndjenë të shtëna armësh. Të nesërmën në drekë, tutje nga lumi krisën të tjera armë. Afër mbrëmjes krisën mitrolozat dhe plasën granada.

— S'po duken, — pëshpërisnin partizanët kur afroi muzgu i mbrëmjes. — Do t'i kenë dik-tuar. Kot nuk krisën gjithë ato armë.

— Krismat s'tregojnë gjë. Harruat se gjermanët për një fësht harxhojnë një thes me fyshekë?

Partizanët u shtrinë të merrnin një sy gjumë. E ndërsa shtrëngoheshin njeri pranë tjetrit që të ngroheshin, në pyll oshëtiu zëri i rojes:

— Erdhi Tasja!

— Erdhën? Sa mirë! Partizanët brofën në këmbë.

— Po «Memeci» ku është?

Korieri mezi ecte. Me ta marrë në krahë humbi ndjenjat. Erdhi në vete shumë vonë e foli mundim. Rrugës kishin rënë dy herë në përpjekje. Shtabin mezi e kishin gjetur.. Më keq e kishin patur kur qenë kthyer. I qëllonin nga të katër anët. Tasen e kish marrë një plumb në sup dhe qe trullosur. Mbante mend se Nurja e kish ngarkuar në shpinë, pastaj s'dinte nga kishin shkuar. Kur ish përmëndur ndodhej në një pyll fshehur në një përrua të vogël dhe, pranë tij, kish Nuren e gjakosur në faqe.

— Qenke plagosur? — e kish pyetur Tasja. Në vend që t'i përgjigjej Nurja i kith thënë:

— Ecën dot?

— Do eci se s'bën.

Tjetri kish përgjuar një çast dhe i qe kthyer korierit:

— Nisu! Matanë çukës me tre bredha është shtegu që të çon te kompania.

— Po ti?

— Ikë, se po afrojnë.

— Pa ty nuk nisem!

— Dëgjo, vëlla! Letra ka urdhëra të rëndësishme. Ti je korier dhe duhet ta shpiesh. Unë do të të mbroj e do të të ndjek nga pas.

Pranë tyre qenë ndjerë lehje qenësh dhe disa degë bredhash, të kositura nga plumbat, këshin rënë mbi të dy partizanët.

— Ikë, Tase, mos humb kohë, — kish ngulur këmbë përsëri Nurja.

Korieri qe nisur. Kur kish arritur afër çukës kish dëgjuar granadat e Nures.

Atë natë asnjë nga partizanët nuk mbylli sy. Larg tyre, fshehur në errësirë Vangjelia fshinte lotët që i rrëshqisnin nëpër mollëzat. Dikush ia nisi me zë të ulët këngës së Flamurit të Kuq, po Tasja, me ta dëgjuar, ja ndërpren:

— Është akoma shpejt për ta kënduar atë këngë pa Nuren, — belbëzoi si në kllapi.

— Mor po, pse i pëlqente aqë shumë kjo këngë? — pyeti njeri.

— Se për shkak të kësaj kënge, që e këndo- nin i vëllaj dhe e motra, i vranë familjen.

Të nesërmen lufta nisi që pagdhirë. Nga dreka partizanët çanë rrëthimin. Dy ditë më vonë kompania u bashkua me bataljonin. Dhe ja në mes të haresë, u dëgjuan zëra.

— Po vjen «Memeci»!

E mbanin mbi një tezgë katër fshatarë. Sho-

kët mezi e njohën, aqë që tretur dhe nxirë. Në trup i kishin hyrë cefla granatash.

— E gjetëm pardje, në një shpellë sipër fshatit, — thanë ata. — Bëmë çmos ta mbanim, po s'kish zot t'ia mbushte mëndjen të qëndronte tek ne.

E vendosën në çadrën e shtabit. Vangjelia me infirmieren i ndenjën te koka. Nurja binte shpesh në kllapi. Vetëm dy herë hapi sytë, dhe, duke njohur shoqen e kompanisë, i buzëqeshi; bile, u përpoq edhe t'i thotë diçka. Më vonë e nisën për në spitalin e brigadës. Vangjelia e përcollti gjetutje tek një breg dhe qëndroi atje si e shastisur.

— Mbaje veten, — i dha zemër komisari.
— Do rrojë, vallë? — e pyeti ajo tërë ankth.
— Trimat nuk vdesin, shoqe!

FLETË NGA NJË DITAR I VJETËR KUJTIMESH

27 Gusht

...Vendosëm ta kalojmë natën te fshati përballë rrugës automobilistike. S'kishim bërë as dhjetë minuta nëpër nonopatin e grykës, kur my-safiri i huaj qëndroi dhe, pa ia çqitur sytë shtepive prej gurësh të bardhë më pyeti:

— Ke ndonjë të njojur atje?

— Më fal një minutë, — iu luta dhe pastaj iu drejtova një malësori të vogël, nja katërmbe-dhjetë vjeç, që, me ecje të lehtë e të shpejtë si të ketrit, posa na kish arritur.

— O trim, sa orë mban fshati që këtu?

— Për ju.... — Vogëlushi vështroi pantallonat e hekurosura dhe këpucët e mysafirit, — për ju, nja dy orë, po, besa.

— Ky është i huaj, — i thashë djaloshit, duke i treguar mikun. — Dhe që të vinte për të na parë, iu desht të bënte udhë të gjatë e të hiqte shumë telashe. Makina na u prish; ne diku duhet të flemë sonte.

Malësori i vogël na u afrua, vuri dorën në zemër dhe u përkul lehtë.

— Urdhroni në shtëpinë tonë! — na ftoi.

Sipas zakonit të vendit, ai rroku në qafë të huajin, pastaj mua dhe priu përpara.

— Ja ku e kemi të njohurin, — qesha më mysafirin.

Ky vuri buzën në gaz dhe tundi kryet sikur deshi të thoshtë: «Ç'njerëz të çuditshëm qenkeni ju shqiptarët».

Udhëtuam plot dy orë. Rrugës Marku, (kështu e quanin djaloshin), na foli për shumë gjëra. Na recitoi edhe vargje këngësh trimërije, edhe vargje nga legjendat e kreshnikëve.

— M'i ka mësue axhë Gjeta, — m'u përgjegj kur e pyeta.

I huaji, që ndiqte këngët me shumë interes, me t'iu afruar shtëpive të fshatit, më tha në gjuhën e tij.

— A do të kish mundësi ta kalonim natën te axhë Gjeta?

Marku, si t'ia kish blerë mëndjen, ia priti, duke na treguar kullën më të afërt:

— Kjo asht shtëpija ime. Urdhnoni te ne, — dhe, pa mbaruar mirë fjalën, hapi portën e thirri:
— Tatë, sonte kemi mysafirë!

— Mirse të vinë, — u dëgjua që brënda një zë burri. Pak caste më vonë, i ati i Markut, Mirash Pjetër Deda, zbriti shkallët me ngut, na përqafroi dhe vijoi: — Shtëpia e miqve asht!

Në çardhak na priten gratë: zonja e shtëpisë, nusja e Pjetrit (djalit të madh të Mirashit) dhe motra e Markut.

Kaluam një mbrëmje të bukur. Për t'u takuar me mikun e Shqipërisë erdhën plot fshatarë. Ve-

tëm Pjetri nuk u duk. Axhë Gjeta na tregoi plot episode trimërije. Mysafiri i huaj i mahnitur s'pushonte së mari shënime.

I zoti i shtëpisë nuk lojti nga qoshja e vatrës. Ndryshe nga ç'e donte rregulli, ai nuk para merrte pjesë në muhabet. Fliste më të rrallë, shpesh e tretëte shikimin nga zjarri; bile, sa herë që hynte Marku në dhomë, plaku i hidhte një vështrim të shpejtë e të çqetësuar. U gjallërua vetëm kur mysafiri i huaj nisi të tregojë për pengesat që kish hasur për të ardhur në Shqipërinë mike.

Nga mesnata menduam të flinim; na duhej të çoheshim heret, që të sosim me kohë në Tiranë. Po, tekxa i kërkonim leje zotit të shtëpisë, dëgjova Gjetën t'i pëshpërisë atij.

— Mirash, me shokët e pleqnuem gjan' e gjatë. S'ka pse ta marrësh për keq që mysafirët e tu të flejnë sonte në shtëpitë tona. Pjetrit nuk i dihet...

— Mos! — ia preu fjalën Mirashi. Fytyra iu ngrys. Ura e zjarrit, që mbante në dorë për të ndezur cigaren iu drodh. — Mos e thuej dy here ate fjalë Gjetë. Sa do që ndodhem ngusht, mikut do t'ia siguroj prehjen e qetësinë. Mysafirët do të qëndrojnë këtu!

Na shtruan në një dhomë të veçantë. Ndonsë isha i lodhur gjumi, nuk po më zinte. M'u duk se as njerëzit e shtëpisë nuk flinin. Herë herë dëgjoja pëshpërima. Njerëzit kishin kujdes të hapnin dyert pa zhurmë e të ecnin në majë të gishtave. Nga oborri kohë më kohë, vinin zëra të ulëta, po unë nuk dalloja dot se ç'thonin. Një burrë i çfrynte qenit që angullinte. Nga ora tre, tek dremitja, m'u bë sikur në dhomë pranë nesh, dikush klithi

e nisi të vajtojë mbyturazi dhe me ngashërim. Një foshnje zuri të qajë. Pak çaste më vonë, të tjera pëshpërima.

— Do jenë gratë, që përgatisin mëngjesin për ne, — mendova.

Në mëngjes na gostitën me kafe pa sheqer, na dhanë të hamë, na mbushën çantat me ushqime dhe ne u gatitëm për udhë. Në çardhak zonja e shtëpisë e hutuar e më sytë të skuqur na përshëndoshi me zë të mekët. Nusja e Pjetrit nuk na doli, ndërsa vajza e Mirashit, na rroku pa na thënë asnjë fjalë dhe mori nga dhoma me hapa të shpejtëa.

— Mrikë.! — e ndali zëri i të atit. — Jepi Markut pushkën e të vëllat se do të përcjelli mysafirët deri poshtë në xhade!

Mrika ngriu. Vura re supet e saj të lëkunden nga drithma. Një ofshamë e thellë i doli nga gjoksi. Me duart që i dridheshin hoqi nga muri pushkën e Pjetrit dhe ia vari në sup vëllajit të vogël.

Në oborr qenë mbledhur shumë malësorë. Na uruan udhë të mbarë. Mirashi na përcoll li gjer te praku i portës.

— Ma bani hallall, — më tha me fytyrë të pikëlluar. — Nuk e prita mikun e Shqipnisë si e kërkon ndera jonë!

Moti atë mëngjes qe i bukur, megjithatë, qelli i pastër e flladi i freskët nuk më ndollë, gjëzim. Diçka e rëndë, si një gur, ma shtypte zemrën. Ndoshta qe nga lodhja e pagjumësia, nuk e di, veç fjalët e Gjetës, ngashërimi i mbytur i natës, duart e Mrikës që ndridheshin, më yshtnin mendime të zymta.

Ndryshe dukej mysafiri i huaj. Ai tërë entuziazëm sodiste natyrën dhe fliste me zjarr për le gjendat shqiptare.

— Sikur i shoh të gjallë edhe sot kreshnikët tuaj tek përleshen me armiqjtë. Atje, — dhe më tregoi një shkëmb rrëzë pyllit të dendur përballë, — atje duhet të jetë varri i Gjergj Elez Alisë dhe motrës së tij. Ndoshta, në këto çaste, kreshnikët e tjerë janë në kuvend thellë në pyll.

— I dashur mik, — nisa t'i them. — Që kur dolën armët e zjarrit morën fund edhe kreshnikët. A po jo, Mark? — i u ktheva malësorit të vogël. që këtë radhë printe në heshtje.

Marku tundi kryet dhe foli:

— Axhë Gjeta na ka rrëfye se edhe tani pyjet janë plot me kreshnikë. Ai na ka tregue disa prej tyne.

— Cilët janë? — u hodh mysafiri i huaj.

— Janë gjurmat e luftës së partizanëve, vorret e tyne, — u përgjegj malësori katërmbe-dhjetëvjeçar dhe vijoi udhën në heshtje.

Prusë ndeshëm një grup malësore. Çudi! Ata më parë rrokën në qafë Markun, pastaj neve. Zemra më theri. Mendime ogurzeza nisën sërisht të sillen në kokën time. Po nuk arrita të mendoi gjatë. Tek një kthesë u ndodhëm ballë për ballë me një malësore të thyer në moshë, që po i ngjitej së përpjetës me ngut.

— Mark! — klithi ajo dhe u turr te dialoshi.

— Pjetri, trimi i t'ezes, si na la të shkretë...

— Mos, t'aze, — bërtiti malësori i vogël, duke vënë gishtin para hundës. — Mos, se po shqetëson mikun që ka ardhë nga larg më na pa!


Tepër vonë. Tezja e Markut, padashur, na zbuloi atë, që shtëpia e Mirash Pjetër L'edës na e fshehu.

— Ç'ka ngjarë? — më pyeti i huaji duke më parë të zverdhur.

Mezi arrita t'i shpjegoj se, ndërsa ne flinim të qetë, në dhomën përbri Pjetri kishte vdekur!

Në fillim mysafiri nuk më kuptoi. Disa çaste më vonë ai u mbajt te trungu i një peme, qëndroi një copë herë si i shastisur, pastaj ngriti sytë nga fshati. Po shtëpitë prej gurësh të bardhë, që shëmbëllinen si muret e ndonjë kalaje të lashtë, nuk dukeshin. Sipër grykës së thellë spikatnin vetëm kreshtat e malit shkëmbor dhe qielli i kaltërt.

829



AI I BANKËS SË FUNDIT

— Ka ndonjë muaj që Stefani është huuar fare, — më thosh Trifoni, anëtar i këshillit, sa po hymë në fshat. — Shikoje arën si e ka braktisur.

— Pse e paska humbur? — e pyeta i habitur. Stefanin ma kishin cilësuar si një bujk të zotin, megjithëqë dukej i ngathët. — Mos është sëmurë?

— S'po e marrim vesh. Tërë ditën rri mbyllur në haurin e vet. Del vetëm në mbrëmje, kur vjen në shkollë. Edhe aty rri si i mpitë. E kemi pyetur kaq herë po s'na përgjigjet. Eja, po të duash, sot në shkollë se kemi kurs. Atje do ta takosh.

Shkova në shkollë që atë mbrëmje. Në klasë hyra pa u ndjerë. Fshatarët as që më vunë re. Trifoni, me abetaren në dorë zbërthente rrrokjet me vështirësi. Të tjerët, përkulur mbi bankat e vogëla e me sytë e picëruar ngulur te libri, përpinqeshin të ndiqnin anëtarin e këshillit. I lëviznin buzët thuajse në të njëjtën kohë me të dhe në klasë pëshpërima përhapej si oshëtimë e mbytur e tingujve, që Trifoni shqiptonte me zë të lartë. Vetëm Stefani i kish buzët të kyçura. Edhe atë mbrëmje, si një vit më parë, ai rrinte fill'i vetëm

në bankën e fundit, me qafën shtërnguar mes supeve. Vetullvrenjtur, me dellin e ballit të kërcyer ai vështronte në një kënd të klasës, i humbur në mendime.

Iu afrova në majë të gishtave. Stefani më ndjeu dhe u ngrit menjëherë në këmbë. Sytë e tij të futur thellë e të rrethuar nga një mori rrudhash të vogla u gjallëruan për një çast.

— Rri, mos luaj, — i pëshpërita dhe u ula pranë tij. — E, si i ke punët me kursin?

Ai buzëqeshi i turpëruar, vështroi një copë herë Trifonin dhe belbëzoi.

— Mirë venë, po mësojnë.

— S'të pyeta për të tjerët. Ti si shkon?

— Ah, unë?... — Stefani fërkoi mjekrën dhe uli sytë: — Ti e di punën time.

...Me Stefan Puranin, ish lopçarin e Josif Damangës, ishim versnikë dhe nga i njëjti fshat, po unë ika që andej në vogëli dhe u ktheva pas luftës. Stefani kish mbetur jetim që gjashtë vjeç. Afendikoi i fshatit tonë (kështu e thërrisin Josif Damangën në ato kohëra), me që t'ëmën e jetimit e kish patur kushërirë të dytë, e mori fëmijën në shtëpinë e vet. Mbaj mënd se më vonë (Stefani cuhej të qe dymbëdhjete vjeç), vendin për të fjetur ia kish rregulluar te hauri i hajvanëve, ngjitur me ato të bagëtive, me qëllim që jetimi, ta kish më lehtë t'i grazhdonte kafshët natën.

Me ne, moshatarët e tij, rrinte shumë rrallë. Ndonse ngrihej pa zbardhur drita dhe strukej në furrikun e vet natën vonë, ne e takonim vetëm ndaj të ngrysur, kur kthehej me bagëtinë e Josifit. Dhe e kishim zili: shpesh ai zbriste nga mali me thëllënxa, turtuj apo cërre, që i zinte me

gracka. Shumë herë i qemë lutar të na falte, në mos ndonjë thëllënëtë gjallë për kuvli, të paktën ndonjë cërrë të vrarë. Po kot e harxhonim frymën. Stefani na shihtë i pataksur dhe largohej duke tundur kryet.

Në shtëpi e thërrisin leshko; ndoshta nga që rrinte përherë i ndrojtur e me sytë përdhe; mbase nga që dridhej dhe fuste kryet mes supeve, si për t'i shpëtuar ndonjë rreziku, sa herë dëgjonte zërin e Josifit. Kisha dëgjuar se një ditë afendikoi u kish molloisur disa shokëve të tij:

— ...Ja, kështu, i hipi në kokë të vinte në shkollë me djalin tim. Pa po ia mbloida paq: «Ku mëson dot ti, mor leshko. E di apo jo se je gjysmë njeriu, se perëndia të ka bërë çyryk nga mëndja. Sa herë duhet të ta them këtë?» Është me tërë mënd budalla. Po e le pa punë s'e ka për gjë të shtrihet si kërric dhe, le të jetë trualli si të dojë, ai ka borxh t'ia këpusë menjëherë një gjumi kaq të thellë, saqë për ta zgjuar duhet t'i biesh me shqelma. Kështu është puna e tij. Gjene, shyqyr që nuk ka fjalë!

Stefanin e pashë pas luftës, nga vjeshta e 1946 ës, kur sapo qe përfunduar reforma agrare. I kishin dhënë tokë, një pëndë qe dhe një mushkë nga të afendikojt. Josifi, për çudinë e të gjithëve, nuk i mbajti mëri; përkundrazi, e nxiti t'i merrte. I fali edhe haurin e qoshes së oborrit dhe e ndihmoi ta bënte shtëpi banimi.

Mezi e njoha kur e pashë. Qe pjekur nga dielli. Lëkurën, në fytyrë e në qafë, e kish plot me rrudha "syt" e futur thellë nuk kishin as më të v' gelin shkëslqin. E pra, nuk ish veçse tridhjet e qjashtë viec.

— S'qenka martuar? — pyeta mësuesin e fshatit.

— As që të përgjigjet po t'ia zësh me gojë. Më 1940 e kish ndërmënd po duket hoqi dorë se kur e mori vesh Jósifi u gajas së qeshuri një muaj të tërë.

— Është i afruar ndopak me të tjerët?

— Jo. Punon për qamet, po me të sosur dita mbyllet në shtëpi.

Parvjet, mësuesi deshi ta regjistronte në kursin kundra analfabetizmit dhe, sa herë e takonte, i fliste për të mirat e shkollës. Stefani e dëgjonte gojëhapur, herë herë psherëtinte thellë; pastaj tundëte kryet, ulte sytë përdhe dhe belbë-zonte:

— Kot lodhesh me mua, o Tili. Ti e di punën time.

Po Tili nuk i u nda dhe, kur erdha vjet në fshat, mësuesi kish arritur t'ia mbushë mëndjen sa të vinte të paklën, në klasë me fshatarët e tjerë. Qeshë ulur pranë tij në bankën e fundit dhe e nxisia të vizatonte në fletore vijëzat, që mësuesi i shkruante në dërrasën e zezë.

— S'e bëj dot, — më përgjigjej.

— Provoje, mbase ia del.

U kandis njëherë. Dora e tij e madhe, tërë kallo dhe e pa stërvitur bëri një vijë të shtrembër, të shëmtuar.

— E sheh? Unë nuk jam për të tilla gjëra, — më tha i mërzitur, duke fshirë pikat e djersës, që i kishin mbuluar ballin.

— Kjo u ndodh në fillim të gjithëve, ndaj jepi! — ngula këmbë gjatë gjithë mbrëmjes, tek e shihja të qëndronte si i ngrirë. Vonë, ai m'u përgjegj i pikëlluar:

— Kot merresh me gjysmakun e perëndisë.
Unë s'jam si të tjerët.

Unë shtanga për disa çaste.

Një herë tjetër, tek më përgjigjej po në këtë mënyrë, mësuesi nuk e përbajti dot veten dhe u hodh:

— Tamam! Të tjerët nuk janë vërtetë si ti, që po e lejon akoma kulakun e drejtë të të thi'hë gjakun. — Tili m'u drejtua: — Në kohën e reformës agrare ne nuk i ramë hiles së Josif Damangës. Ai e mori Stefanin me të mirë dhe e mbajti pranë që ta milte si edhe më parë. I pëshpëriti: «Ne të rrijetëm, të dhamë edhe shtëpi. Le të vijë keq për ne, siç na erdhi ne për ty. Nuk po e shikon se perëndia e solli që ti të na e lash këtë borxh?» Dhe Stefani bëhet copë për kulakun, i ndihmon në arë e në lëmë, i shtije drutë e dimrit, i fshin hauret e bagëtisë... E Stefan, s'është kështu?

Stefani heshte.

Sivjet mësuesi e mori përsëri në kurs dhe unë e gjeta përsëri po në atë vend ku qëndronte një vit më parë.

... — Stefan, — i them duke i treguar gërmat «i» dhe «u», — i njeh këto?

Ai mblodhi buzët, vështroi një copë herë germat dhe foli i pasigurtë:

— Kjo është «i»,

— Të lumtë. Paske nisur të mësosh, po kjo tjetra?

Stefani u vrejt. Nuk i kujtohej. Megjithatë nuk u dorëzua. Picërrroi sytë, vrau mëndjen dhe, pas pak, u përgjegj me ndrojtje:

— Kjo është... është «u».

— Shumë mirë. Tani merre lapsin dhe shkruaji brenda këtyre vijave.

I pasigurt mori lapsin dhe bëri një vijë të gjatë si shkarpë sa gjysma e fakes së fletores. Nuk u kënaq. Me bisht të syrit vështroi fletoren e shokut përpara dhe shkronjat e tij të vogla, cëndë vijave të ngushta, i *irudhi* sërisht nië sy shkarravinës së tij, ngrysi vetullat dhe qëndroi i ngrirë me lapsin që i dridhej në dorë.

— Pse e prish gjakun? — i dhashë zemër.
— Shikoji shkronjat e ditëve të para të Trifonit. A nuk u ngajnjë edhe ato gëlistrave dhe këmbëve të pulës?

Stefani pa fletoren e Trifonit po nuk e hapi gojën. Të nesërmen më tregoi fletoren. Kish mbushur dy faqe me «i» dhe «u». Edhe këtë radhë gërmat i kish bërë të shëmtuara.

— I kam shkruar natën. Një fletore e prisha se nuk e qëllova dot, — më shpjegoi.

— S'është nevoja të lodhesh kaq shumë. Ti mund të mësosh fare mirë edhe pa e gdhirë, — e këshillova, si vura re se qe dobësuar.

Stefanit i qeshi një çast fytyra dhe u mat të më thosh diçka, po menjëherë kapërceu pështymën e u largua i vrejtur në fytyrë. Të nesërmen m'u afrua gjene, qëndroi një copë herë pa folur dhe prapë u largua. Të pasnesërmen ai erdhi në kurs me fletoren të mbushur përgjysmë me «i» dhe «u» dhe me një copë gazete.

— Dy «u» i gjeta, — më tha i gëzuar si një fëmijë, duke më treguar titullin e një artikulli. «I» nuk më zuri syri.

Atë mbrëmje Stefani lexoi për të parën herë abetaren.

— Po vijove kështu, do t'arrish shpejt të tjerët, — e përgëzuan të gjithë.

Stefani na pa si me habi.

M'u duk se diçka e mundonte, se donte hem t'ë na pyeste, hem sikur trëmbej, sikur i vinte zor.

Tërë atë ditë nuk kish dalë fare jashtë. Më thanë se kish bërë fjalë me të shoqen e Josifit. I vajta në shtëpi dhe qëndrova me të një copë herë. Qe hequr në fytyrë akoma më shumë. Duart i digjeshin.

— Sëmurë je, apo rri tërë natën me fletoren dhe abetaren në dorë?

— Nuk e di. Kam ca netë që s'më zë gjumi. Demek, unë... —

— Folë, Stefan, ç'të mundon?

Stefani rrahu me të shpejtë qerpikët dhe uli sytë.

— Demek, unë që po mësoj të shkruaj, nuk jam... leshko? — më pyeti me gjysëm zëri, duke u dridhur dhe m'i qepi sytë, sikur priste me ankth përgjigjen time.

— Akoma s'paske hequr dorë nga ky mendim? Po t'ë ish ashtu as mësuesi, as ne të tjerët nuk do të ngulnim këmbë të vije në kurs.

— Kështu më tha edhe Tili.

— Po arat e bagëtinë pse i ke braktisur? — e pyeta.

Stefani tundi kryet e shtrëmbëroi buzët:

— S'vjen e keqja nga ato, — m'u përgjegj me giysmë zëri.

Kaluan dy ditë. Papritur, në mëngjes, dëgjova një klithmë lemerije, pastaj kuje. Dola nga shtëpia me një frymë dhe mora udhën e

mëhallës së sipërme, nga vraponin të gjithë.

— Ç'ka ngjarë? — pyeta një fshatar.

— Stefani vau Josifin.

— Nuk arriti, — ia priti një tjetër. — Vëtëm sa e plagosë.

Te porta e shtëpisë së Josif Damangës ndësha Trifonin dhe dy fshatarë të tjerë, që po nxirrin Stefanin jashtë. Në oborr, e shoqja e kulakut me shaminë e kokën pas, me gërshtat të çthurura e pa një pikë gjaku në fytyrë, fliste e lebetitur:

— Lidheni se u çmënd! Kish javë që grindej kot së kati. S'e kish bërë kurrë më parë këtë gjë. Sot në mëngjes u tërbua fare. Zuri të na thosh njëmijë e një llafe. Pastaj, o zoti Krisht, i kërcyen sytë përjashta, rrëmbeu sopatën dhe iu turr tim shoqi... Desh perëndija, arriti Trifoni dhe i mbajti dorën... Amani, virjani hekurat dhe çporreni nga fshati!

E shpunë Stefanin në zyrën e këshillit. Rrugës Trifoni më shpjegoi:

— Ditët e fundit Stefani nuk i shkelte në shtëpi Josifit. Bile, pardje dhe dje mbrëma, i kish vajtur kulaku në dhomën e tij dhe qenë grindur. Sot në mëngjes u zunë gjene. Arrita të dëgjoj Josifin që e kërcënoi: «Kështu, ë; të ka hipur në kokë të mësosh. Atëhere, çporru nga shtëpia, se është imja, leshkua i djallit!» Stefanit i hipit gjaku në kokë dhe iu turr me sopatë duke iu kanosur: «Na, qafir, për shtëpinë tënde!»

E pvetëm Stefanin.

— Për një haur e bëre këtë hata?

Ai nuk na u përgjegj. Ish ende i egërsuar dhe qëndronte si gur. I vajta pranë.

— Ç'pate, Stefan?

— Ç'pata? — Stefani rrudhi vetullat më shumë dhe, zuri të flasë ngadalë e shtruar: — Të gjitha të zezat i hoqa nga ai kukuth. Nga ta zë më parë: trupin që ma cfiliti, zorrët që m'i thau, apo të ritë që ma shoi... Donte edhe haurin? Le ta marrë edhe atë. Të gjitha ia kam falur. Veç... veç një gjë nuk do t'ia fal dot kurrë. — Qimet e flokëve iu ngriten përpjetë dhe nosullat i kericitën. — Për tridhjet vjet me radhë, që ditën e mallkuar që më rrasni në haurin e vet e gjer sot, për tridhjet vjet, ditë për ditë e natë për natë, ma tiposi në kokë se perëndia më paskësh bërë çyryk... se unë s'jam për shkollë e për grua, s'jam si të tjerët... Këtë nuk do t'ia fal... Pse s'më latë ta bënja copë e thërrime!...

— Qysh do të linim, — i foli kryetari i këshillit. — Sot nuk lejohet ta vrasësh tjetrin. Kemi ligje, gjykatat tonë, kemi...

— E di, — e ndërpree Stefani. — E mendova shumë edhe atë. Veç atë që më ka bërë ai mua s'e gjykojnë dot gjykatësit. Oh, — psherëtiu thellë pas pak. — Oh, tani që edhe unë jam njëri, le të më dënojnë sa të duan.

Ish lopçar, ngriti kryet e na vështroi pa ndrojtje. Qe dobësuar shumë. Faqet i qenë bërë gropë. Vetëm sytë e futur thellë e të rrethuara me një mori rrudhash shkëlqenin. Dukej si i përtërirë.

I N F E R M I E R J A

«BABAI VJEN TË SHTUNËN PËR
CELEBRIMIN TEND. TË PUTH SOFIKA».

Me telegramin e motrës në dorë, Margarita, infermierja e repartit infektiv, hyri në pavion tërë gaz e hare.

— C'qënke ngritur kaq herët? — pyeti shoqja e saj e shërbimit. — Apo erdhe me Skënderin?

— Skënderi vjen sot me trenin e orës dhjetë.

Tjetra e pa me habi:

— I fejuari yt dje pas dite qe këtu; pruri një tē afërm të tij që e shtruan me urgjencë në pavionin e dizanterisë, dhe, në mos më paçin gënjyer veshët, s'ka shumë që ia dëgjova zërin.

— Qënka këtu! — Margarita u sul në koridorin e pavionit të dizanterisë me aq vrull sa mënd u përplas me tē fejuarin, që po dilte nga dhoma numur dy.

— Skënder, — thirri duke parë fytyrën e tij të zymtë. — C'ka ngjarë? C'ke që je kështu?

I fejuari kapërceu pështymën me zor, u vrejt më shumë dhe pa e parë më sy, u përgjegj me zë tē ulët:

— C'kam që jam kështu?... Kur tē ngrenë kurth, sibas tēje, duhet tē hedh valle, ë?

— Kurth! — Margarita e çqetësuar iu afrua më tepër. — C'flet kështu? Kush ta ngriti?

— Një femër e çthurur, që s'e ka për gjë të bjerë në shtrat me njeriun e parë që i lutet, kurse mua më hiqej si engjell, — foli ai me përbuzje.

Margarita u zverdh, trupi iu bë akull dhe një rënqethje e përshtkoi nga kryet gjer te këmbët.

— Mua... mua më quan të atillë! — belbëzoi e trembur, pa i besuar akoma ato fjalë.

— Ty, se e tillë je, — ia priti Skënderi duke e ngritur zërin, pa çarë kryet për infermierët e të sëmurët, që zunë të mbanin vesh. — Vetë im kunat më tregoi se ç'bëje ti me të sëmurët kur u matje temperaturën e mbrëmjes në spitalin e...

— Mos!... — arriti të thotë Margarita, që kish zënë veshët me duar dhe, duke ecur si e dehur, doli nga pavioni.

* * *

Mezi sosi në dhomën e saj. Ngashërimi s'e linte të merrte frymë, u lëshua në shtrat përbys dhe qëndroi si e shastisur gjersa u gdhë fare. Në kokë i vërtiteshin mendime të turbullta, të errëta. Herë-herë i bëhej se ish duke parë një èndër të keqe dhe Skënderi i saj do të kthehej i qeshur dhe i përmalluar me trenin e orës dhjetë. Po, në çast, fjalët fyese të të fejuarit i buçitnin me të madhe dhe ngashërimi e mbërhente rishtaz.

Në mëngjes u ngrit me sy të buhavitur, me buzë të thara dhe e zbehtë në fytyrë. Nga téré ajo rëmujë mendimesh një gjë i qe kristalizuar: dashurinë për Skënderin, që ajo e ruante si gjënë më të shtrenjtë të jetës, ai ia kish marë nëpër këmbë.

Me sa shpirt e kish dashuruar, me sa mall

priste kthimin e tij nga shërbimi! Ishte hera e parë që ai shkonte me punë larg saj për dy javë. Margaritës s'i pat shkuar kurrë ndërmënd më parë se, në ato ditë që Skënderin s'e kish pranë, vetëm kujtimi i çasteve të kaluara me të, do t'i ndillte një afsh të ngrohtë plotë ëmbëlsi. Para se të njihej me Skënderin, ajo mendonte krejt ndryshe për dashurinë. Bile, gjer një vit më parë, po të ndeshte në çifte dashnorësh, një rrënqethje krupe e niverije i kalcn'ë nëpër trup dhe skena e një ngjarje të pështirë që i kish ndodhur dikur, i çfaqej me tërë shëmtirën e saj... Një mbrëmje, (posa kish nisur nga detyra si infermiere), tek kontrollonte temperaturën e një të sëmuri, shtruar në një dhomë të vogël, ky, papritmas, e pushtoi dhe e shtriu në shtrat. Margarita e llahtarisor u përpoq të çlirohej e t'u bënte bisht të puthurave të tij. Deshi edhe të bërtiste, të kërkonte ndihmë, vec një mendim i vetëtimtë ia mbërtheu nofullat. Ajo e kish vëth në vesh porosinë e prindërve: «Ruaju, bijë thashethemeve. Mos harro se plagët e zjarrit shërohen, po nuk shërohen dot plagët e hapura nga gjuhët e këqija». Dhe infermierja u kacafyt në heshtje, gjer arriti t'i shkëputet nga duart e të iki nga dhoma me trup e shpirt të vrarë...

Po, ja, nga ajo që qe ruajtur nuk paskesh shpëtar. Skënderi i saj, që ajo mezi priste ta shihte e të strukej e tëra në gjoksin e tij, ia përlieu dashurinë, duke e fyer rëndë.

* * *

Ditët që erdhën qenë të rënda për të. Iu shua çdo gëzim. Sytë i humbën gjallérinë e mëparë-

shme, u bë e ngathët në lëvizje. Jetonte si ndër ethe. I dukej sikur një dredhë e furishme e sillte rrotull me shpejtësi të lemeritëshme dhe Margarita priste nga çasti në çast që ajo ta vërviste në ndonjë humnerë të thellë. Kusn çaste që e ndjente veten të mbështjellë nga një mjergull e dëndur, kish pastaj edhe çaste që e pushtonë një lloj qetësie, që ia cilitëtë më shumë shpirtin e bren-gosur.

— Njeriu duhet ta zotërojë dhëmbjen. — i thanë. I përmëndën se përpjekjet e nxitura nga dëshira për diçka njerëzore e fisnikë platin helmet e jetës, rilindin dëshirën për tò jetuar, dhjetë-fishojnë forcat. A nuk ish shërbimi i saj një detyrrë fisnikë?

Margarita u përpoq t'i kushtohej akoma më shumë shërbimit, me shpresë se do të qetohej sadopak. Veç nuk ia doli dot: puna që më parë e entuziazmonte dhe e emociononte, tani nuk i linte më mbresat e dikurshme. Përkundrazi, shërbimi ia lëndonte plagët or' e çast. I dukej se njerëzit e tregonin nga pas me gisht, ndjente se disa sikur e shihnin me sy të keq kur ajo u kalonte pranë. Dëgjoi edhe pëshpërima: «E la i fejuari se nuk ka qëndrim të mirë moral».

Infermierja nuk duronte dot. I vinte të thërriste: — S'jam e atillë! — Po nuk protestonte. E merrte me mënd se askush s'do ta besonë. Tani ajo e kuptonte se sa e vërtetë qe thënia: «Plagët e zjarrit shërohen, po nuk shërohen plagët e hapura nga gjuhët e këqija».

— S'është e vërtetë, — ngulte këmbë mjeku i pavjonit. — Sot, tek ne, njeriu nuk vlerësohet nga thashethemet, po nga puna që bën. Ne të njojin

mirë, njohim pasionin tënd për shërbimin e infermierës dhe, sikurse thuhet, një vepër fisnike nuk mund të dalë nga një zemër e ligë dhe pa ndërgjegje të lartë, ashtu sikurse një vazo e përsosur nuk mund të dalë nga duart e një mjeshtri të keq.

Këto fjalë e ngrohnin për disa çaste, po më vonë i bëhej si ia thoshnin nga që u vinte keq, nga mëshira. Mëshirë!... E përse? Mëshirohet fajtori kur është penduar, kurse ajo ç'të keqe, ç'turpe kish bërë? Cili ish ky kunat i Skënderit që e paskësh njohur, që e paskësh parë?... Ajo as emrin nuk ia dinte. Në shtëpinë e të fejuarit asaj ia kish zënë syri një herë fotografinë e tij, por tani ndonse përpiquej t'ia kujtonte tiparet nuk ia delte dot. Sa do të donte ta shihte dhe t'ia përplaste në fytyrë poshtërsinë e tij. Dhe duhej të priste mëshirë nga të tjerët? Margarita zjente nga zëmërimi dhe asaj i vinte të thërriste:

— Jo, s'dua mëshirë!

I hipi në kokë të braktiste çdo gjë e të mos shihte njeri me sy. Ku të shkonte? Përposë shtëpisë së saj, nuk kish ku të strukej. Vetëm prindërit do t'ja kup'onin dhëmbjen e madhe, vetëm ata do ta rrëthonin me dashuri të sinqertë. Dëshira për të pështetur kryet, si në foshnjëri, në prehrin e nënës, për të kaluar ditët në atmosferën e ngrohtë të familjes, pranë motrës së vogël, nëpër dhomat e shtëpisë së vjetër, ku çdo kënd fshihte plot kujtime të émbla, i rritej nga ora në orë. Të shtunën do të vinte i ati dhe ajo do të braktiste Tiranën menjëherë.

— I shkreti baba, që vjen me gazin për të marrë pjesë në celebrimin e vajzës së tij! — pëshpëriste Margarita, ndërsa supet i dridhe-

shin nga ofshamet. E përfytyronte zëmëratën e plakut pér fjalët që i kishin hapur së bijës. Si-
doqoftë ai do ta besonte vajzën e tij, duhej ta be-
sonte, se ai e njihtë mirë. Ah, sa të vinte e shtu-
na!

* * *

— Turp të kesh! — gjëmuan fjalët e të atit
me të hyrë në dhomën e saj. — Me ç'sy e faqe
do të dalim tani përpara njerëzisë. Të të kish për-
pirë më mirë dheu, farë e keqe, që na ndyve nde-
rin e shtëpisë.

Margarita u pre në fytyrë... Edhe ai, edhe
ai një lloj si të tjerët!... Gjuha iu mek, gjunjët
iu shkurtuan dhe, që të mos rrëzohej, u mbajt
te ana e krevatit...

— Baba, — nxori një zë të dobët, teksha ka-
fshonte cepin e buzëve, pér të mbytur ngashëri-
min: — Baba...

— Mos më quaj më baba, — e ndërpreu
ashpër i ati. — I mora vesh të gjitha, — shtoi
ai pas pak dhe u drejtua nga dera.

E bija mbuloi sytë me duar, vrapi pas të
atit dhe me trupin e saj zuri kanatin e derës.

— Edhe ti, baba, nuk më beson? — foli me
zë të shuar.

— Nuk del tym pa zjarr, po hapmë rrugën,
të them!

Margarita vari kryet, nxori një rënkim të
thellë dhe u mbyll në vetvete.

Natë. Çdo gjë rrötull që zhytur në errësirë.
Në xhamat e dritares pikat e një shiu të rrëm-

byer përplaseshin me forcë. Po infermierja s'dëgjonte gjë, veç goditjeve të rënda të zemrës. Qëndroi një copë herë pa lëvizur. Pastaj u ngrit dhe, pa u krehur e pa veshur mushamanë, mori udhën për në spital. Atë natë ajo kish shërbimin e rojes.

Ekte pa vënë re ku hidhte çapat dhe nuk kujtohej për shiun që i binte në fytyrë, që i kish kokolepsur flokët në qafë e që po e bënte qullë. E cënuar në ndjenjat e saj më të shenjta, e përbuzur nga njeriu më i dashur (sa i therte në zemër kur mendonte Skënderin!), e braktisur nga prindërit, ç'i mbetej më asaj? Fjalë boshe ato të mjekut të pavionit se njeriu nuk u vlerësoka sipas thashethemeve. Jo, gjuhët e këqija i hapën asaj plagë që s'do t'i shëroheshin kurrë, plagë që i shuan çdo gjësim e dëshirë për të jetuar. E viente të jetohej një jetë e tillë?

Shiu binte me të madhe. Infermjerja ecte si e humbur ndërsa gumëzhima e rrëkeve të shit i përsëriste pa pushim: ...s'ka rrugë tjetër, s'ka rrugë tjetër!...

* * *

Si mbaroi kontrollin e mbrëmjes, Margarita u mbyll në dhomën e infermieres së rojes dhe u ul afér tryezës përballë vazos me tufën e termometrave.

— S'ka rrugë tjetër! — mërmëriti e theu me shumë kujdes majën e termometrit të parë. Lëngun helmonjës ngjyrë argjëndi e derdhi në një filxhan të vogël. Duart i kish akull, po ve-

ten e ndjente të qetë. Heshtja e pavionit sikur i jepte zemër. Kapi termometrin e dytë. Në çast tingëlloi zilja e telefonit. Në heshtjen e thellë ajo kumboi si një këmbanë e fuqishme. Infermieres i ngriu gjaku. Një drithmë frike i kaloi nëpër trup dhe termometri i shkau nga duart. Iu duk sikur aparati, me tingujt që s'pushonin, kërkonte të jepte kushtrimin për veprimin e kobëshëm që ajo po ndërmerte. Margarita e humbi 'oruan dhe pa e kuptuar as vetë, ngriti dorezën e telefonit.

Në anën tjetër një grua pyeste për gjendjen e një të sëmuri të pavionit të dizanterisë, që atë pas dite kish patur dhëmbje e temperaturë. Zëri i saj ish i çqetësuar dhe infermierja, duke harruar për një çast brengën e vet, e mori me mënd ankthin e femrës në anën tjetër të telefonit, ankthin e njeriut që i rreh mëndja dhe vuan për të aférmin e tij të sëmurë. Me siguri pranë asaj gruaje prisnin të tjera njerëz me padurim. Të nesërmen ata do të vraponin në spital për të parë, për t'i qëndruar pranë, për ta rrethuar me dashurinë e nënës, gruas, motrës, të miqëve, me atë dashuri njerëzore, pa të cilën jeta i ngjan një bime të thatë në shkretëtirë.

— Më dëgjoni, shoqe? Ju lutem si është i sëmuri në dhomën numur dy të pavionit të dizanterisë?

Infermierja e mbledhi vehten dhe për ta qetuar gruan, iu përgjegj.

— Mos u çqetësoni, shoqe. Dhembjet kanë kaluar. Po vete ta shoh.

Në dhomë Margarita nuk gjeti njeri dhe do të largohej sikur të mos dëgjonte një rënkim të

thellë poshtë shtratit nga ana e murit. I sëmuri mbledhur kulaç përpélitej me të madhe, duke përdredhur trupin e kërcitur dhëmbët. Fytyra i qe mbytur në djersë, sytë i qenë maviosur dhe mezi merrte frymë; po kalonte një krizë të rëndë.

Infermierja e tronditit vrapoi ta ngrinte, veç pa e prekur mirë, u zembraps e tmerruar: pérpara saj shtrihej ai që dikur qe orvatur ta çnderronte. Një tjetër mendim e tmerroi akoma më tepër; nga ajo dhomë kish parë të dilte Skënderi. I sëmuri rëndë ishte i kunati i tij.

Margaritës iu errën sytë. Kish menduar mjaft herë, në ato ditë të fatkeqësisë saj, se po ta takonte do të hakmerrej kundër tij. Tani e kish pérpara. Urrejtja nisi t'i vlojë pérbrënda. Ajo shtërngoi nofullat dhe mbylli sytë... (pastaj mblodhi duart grusht dhe zuri të largohej. Ja, kapérceu pragun e derës, térhoqi pas vehtes kanatin, doli në koridor dhe...) Margarita, pérpéliti qepallat: nuk kish lojtur fare nga vendi; bille, si ta shtynte diçka kundër dëshirës së saj, u pérkul mbi të sëmurin, e vendosi në shtrat dhe lajmëroi mjekun e rojes. Si në mjergull i dilnin më vonë fytyrat e mjekut të pavionit të dizantërisë, të shefit përgjegjës të repartit infektiv, të drejtorit të spitalit. I kujtohej se i sëmuri kish patur temperaturë të lartë, puçërzime të trëndafilta në lëkurë, dhëmbje të mëdha. Dëgjohej të flitej pér një varg analizash urgjente, që po bëheshin në laborator, pér tifo galopante, pér rënien e menjëherëshme të temperaturës, pér agoni. Në fund mbante mend se një nga infermierët e kish shpënë të kapitur në dhomën e infermieres së rojes që të çlodhej.

Ajo qëndroi një copë herë në karrige e trullo-sur. Koka i rëndonte dhe, ndonse sytë i kish drejtuar nga tryeza, nuk dallonte as tufën e termometrave, as filxhanin me zhivë. Përpiquej vetëm të kapte zhurmën që vinte nga koridori, të merrte vesh se ç'po ngjiste matanë derës.

Në koridor ndiheshin më të rrallë vajtje ardhje. Dikush hyri te Margarita dhe u mundua një copë herë më kot të merrte në telefon përgjegjësin e zyrës së konservimit të gjakut.

— Kur ke nevojë për një njeri nuk e gjen kurrë, — foli ai i mërzitur.

— Përse ju duhet përgjegjësi?

— Po bëjmë orvajtjen e fundit, transfuzion gjaku përzier me streptomicinë e bromure të tjerrë. Po ç'e do, s'gjëjmë përgjegjësin për të têrhequr gjak të grupit zero dhe çelësi i dytë ka humbur; megjithëqë s'ma ha mëndja se do të shpëtojë. — Ai iku me rrëmbim dhe harroi të mbyllë derën.

— Po vdes! — mërmëriti Margarita dhe në trup i kaluan mornica. Të bërtiturat e mjekuf dhe zërat e të tjerëve në anën tjetër të koridorit sikur e çponin si turiela:

— Akoma nuk e kini sjellë gjakun?

— S'po e gjejmë përgjegjësin e zyrës së konservimit të gjakut. Kemi dërguar dy veta ta kërkojnë me makinën e drejtorit.

— S'pret puna gjersa ta gjeni.

Margarita u përkul nga ana e derës. Zemra i rrihte fort. Një mendim i kish lindur në kokë po ajo tundi kryet e shtrëngoi buzët për ta larguar

atë. Atë çast shefi i reparit matanë derës, si t'ia kishtë blerë mëndjen bërtiti ashpër:

— Kush nga ju ka gjak të trupit zero? Shpejtoni se po na vdes. Merrni vesh apo jo: po na vdes!

Infermierja ra përmbyss mbi tryezë. T'ia jep-te ajo gjakun e saj njeriut që i shkatërrroi jetën, që e shtyu drejt vdekjes? Jo, kurre! Le të gjenin tjetër kund; gjak të grupit zero nuk kish vetëm ajo.

Ngriti kryet me vendosmëri po nuk pat gu-xim të shohë nga dera e hapur. Ndjeu në gjoks një peshë të rëndë dhe diçka nisi ta përvëlqej brënda. Mendime të çkëputura, si retë e çakërdisura nga tufani, nisen t'i vërtiten në kokë. I çfa-qej fytyra e dikurëshme e të sëmurit tek përpinqej ta shirinte në shtrat, sytë e tij të zgurdulluar nga epshi, i ati i zemëruar me fytyrën e vrejtur e me tëmthat që i rrëhnnin me forcë, Skënderi, i sëmuri në agoni. Në veshë i buçisnin fjalë pa lidhje: Duhet gjak i grupit zero... Farë e keqe që na ndyve nderin e shtëpisë... Kush noa iu ka gjak të grupit zero?... Mos më quaj më baba... E kupëtoni apo jo, po vdes një njeri, po vdes një njeri, po vdes një-nje-ri!...»

Margaritës iu zu fryma. Shtërngoi fort me të dy duart veshët që të mos dëgjonte. Më kot! Buçima s'pushonte.

Ajo s'duroi më. U ngrit, çkopsiti jakën e përparëses së bardhë dhe, me mëntë që i merreshin, u drejtua me hap të shpejtë nga koridcri:

— Merrni nga gjaku im, shoku doktor!

JETËSHKRIMI I NJË MINATORI

— S'më dhe ndonjë mëndje, moj grua, — i tħa major Shabani së shoqes, ndërsa bēhej gati tē flinte. — Vetë s'po i jap dot zgjidhje kësaj pune.

E shoqja, që po ndërronte çarçafet, la punën përgjysmë, u ul në cep tē krevatit dhe vështroi një copë herë flokët e zbardhura tē tij:

— E di ç'të bësh? — iu përgjegj ajo. — Pa rri ca kohë rehat; çlodhu tē paktën një herë si ësh-të pér t'u çlodhur.

Ai vuri buzën në gaz.

— Ama, mëndje më dhe!

— Kaq di, kaq them, — foli gruaja e pakë-naqur. — U bënë njëzet vjet martuar, s'të pashë një herë tē pushosh si njeri, po çqyeju e rropë-oju. Si e ke zënë ti..., — ajo e la fjalën përgjysmë, se i shoqi zuri tē qeshë pa zë. — Mos qesh, Bame!..

— Mirë pra, s'po qesh — dhe u bë serjoz menjéherë. — Sa kohë tē çlodhem, thua ti?

— Pse tallesh me mua? — u hodh ajo e pre-kur.

— E kam me gjithë mënd.

E shoqja tundi kokën.

— Flas seriozisht, — nguli këmbë majori,
— C'thua?

Gruaja s'u përgjegj menjëherë; ndruante se mos i shoqi do të vijonte të qështe, po, duke parë se ai priste serioz, foli me zë të ulët:

— Rri një muaj sa të çmpish trupin.

— Shumë është. Po puna?

— Punë gjen kur të duash, veç shëndetin jo.

Majori krojti kokën. Këto fjalë i kishte dëgjuar kushedi sa herë nga e shoqja. Vendosi të mos ia prishte qejfin.

— Mirë, ashtu si thua ti le të bëhet, — tha ai dhe filloi të heqë çizmet. Si heshti një çast, shtoi: — Sa të rregulloj punën, pastaj do të rri nja pesëmbëdhjetë ditë.

— Bame, s'e ke mirë!

— Më tepër mos kérko — ia preu ai. — S'rri dot më shumë.

— Të paktën gjatë këtyre dy javëve mos u rropëto posht' e përpjetë!

— Prishur mos qoftë! Veç nesër në mëngjes them t'ia mbaj nga miniera.

E shoqja ngrysi vetullat dhe u prish në fytër.

— ... Kam kohë pa vajtur, — vijoi ai pa e vënë re çqetësimin e saj.

Gjer dy ditë më parë major Shabanit as që i shkonte ndër mënd të fliste për pushime e për t'u takuar me shokët e vjetër në minierë. Pat menduar shpesh herë të piqej me ta, po përvëç nja dy vizitave që pat bërë fill pas çlirimit, s'i k'sh ardhur më për mbarë. Këtë radhë punët qenë ndryshe. Para tre ditësh kish dalë në lirim. Komanda dhe Komiteti i Partisë së qytetit i ki-

shin propozuar të punonte në një zyrë. Shabani kish ngurruar.

— Këtë çast s'kam si vendos, — u qe përgjegjur.

— Ke të drejtë, mendohu e na thuaj!

Shabani u mendua, i mati e i peshoi gjërat; veç zgjidhje nuk u dha dot. E çfarë të bënte në zyrë? Ai kurrë nuk qe marrë me punë të tilla. Me ta përfytyruar veten atje, i bëhej se do t'i merrej fryma nga shkresat e dosjet, se do të mërzitez që në orët e para e do të braktiste çdo gjë. Kështu e pat pësuar disa herë dhe në ushtri; apo ulej në tryezën e mbushur me regjistra e formulare s'e mbante vendi e s'priste veç rastin t'ikte një orë e më parë, të futej mes usharëve. Ai çuditej me shkruesin e bataljonit që s'donne t'ia dinte, po rrinte tërë ditën i krrusur mbi tryezë e shkruante e shkruante pa ia bërë një hërrë «of»!... Jo, Shabani e ndjente se s'do t'ia dilte dot mbanë asaj pune.

Po me diçka duhet të merrej. Ishte dyzet e tre vjeç. Gjatë tërë jetës s'kish punuar veç në minierë e në ushtri. Nga miniera qe larguar këtu e trembehjetë vjet të shkuara, që në pranverë të dyzet e treshit kur u hodh në çetën partizane.

— Trembehjetë vjet; sa shpejt ikin vjetët!

— mendoi me habi.

Megjithatë e ndjente se, ndonëse tërë atovite, mbushur me ngjarje të mëdha, qenë rraku-lisur shpejt e shpejt, i kishin lënë gjurmët e tyre në trup, në fytyrë, në flokët.

— Të dal nga miniera e të çmallem me shokët, pastaj shohim e bëjmë, — vendosi kur pa

që edhe gruaja s'e ndihmoj dot, dhe zuri të heqë çizmet.

E shoqja mori frymë t'hellë dhe psherëtiu.

— Ç'ke? — u hodh Shabani dhe e pa me vrejtje.

— Pse do të shkosh atje? — e pyeti ajo me zë të dredhur.

— Hëm!... — ja bëri ai, dhe tha me vehte:
— Djall'o punë; akoma s'i paska dalë frika e minierës

— Pse do shkoj? Të takohem me shokët, se kushedi kur do më bjerë rasti të shihemi me ta, Po ti, mos e pandeh minierën si në kohën e Ibrahim Baçit? — Shabani filloi ta qetësojë: — U plaka, moj grua. T'ish nja trembëdhjetë vjet më parë, mundet; po tani s'pi ujë kazma ime. Mos e prish gjakun, fli rehat!

Megjithatë ajo nuk fjeti rehat. E njihetë mirë të shoqin, e kish parë kaq herë si tretej në mendime kur shihte kamionat me qymyr guri. S'ndryshonte fare nga shokët e tij të minierës, nga Rama, Thimi, Nasi, që po bëheshin gjyshër e s'largoqeshin nga ai vend. Atë mëngjes, si ta kish shtyrë kush, Rama u kish ardhur në shtëpi dhe, që kur hyri e gjersa doli nuk bëri tjetër muhabet veçse për minierën, bile, në të ikur kish thënë:

— Pranë qomyrit s'plaket zemra e minatorit, jo. Ti, moj nuse e Shabanit ndofta s'e kupton si e qysh, po yt shoq e di se, edhe kur të krrusemi më dysh, s'do gjejmë dot prehje vecse në galeri. Apo jo Shaban? — po kur pa që majori në vënd që t'i përgjigjej kish vënë buzën në gaz, i qe kthyer asaj:

— Ke parë ti; s'flet fare i bir i botës!

E shoqja e Shabanit e dinte sa të vërteta qenë ato fjalë, se ajo vetë e kish parë kushedi sa herë të shoq'n të turfullonte kur ish pa punë, të grin'dej e inatosej kur detyrohej të merrej me çikërrima të tjera. Ajo e dinte se atij i hanin duart pér punë. Në vitet e para të martesës ajo s'e kuptonte këtë, mendonte se Shabani mërzitej vëtm nga meraku pér të mbajtur me bukë grua e prindër. Më vonë ajo vuri re se i shoqi digjej edhe nga dëshira pér t'i vënë në lëvizje muskujt e tij të fuqishëm. Mendoi më vonë se këtë etje të dashuar pér punë do ta kish pér soj, do ta kish trashëgim nga i ati, sepse dhe vjehrit të saj s'i zinin këmbët dhé. Po kur njoihu shokët e burrit iu mbush mëndja se edhe ata, si Shabani i saj silleshin. Atëherë iu dukën me vënd ato që i thosh plaka e Ramës që para luftës, pér të shoqin e pér minatorët e tjerë:

— Është pér të vënë duart në kokë, moj nuse. Im shoq ka tridhjetë vjet që punon në bark të malit e s'i ndahet shpirti që andej. Ja ku po të them: do i ketë magjepsur ndonjë e bukur e dhet, pa s'heqin dorë nga kjo punë e rëndë!

Dhe e shoqja e Shabanit vërtitej në shtrat e pshërëtinte thellë tek kujtonte minierën, ankthin që e mbërthente në ato kodra e veçanërisht mbrëmjeve kur i shoqi vonohej: mos, zot na ruaj, qe vrarë, qe plagosur, kish mbetur brenda i varrosur gjallë, qe zënë me kryepunëtorin! Kish vjete që rronte e qetë. Përse, përse të fillonte prap nga ajo jetë me frikë! Pat dëgjuar se miniera qe ndryshuar dhe, siç i pat thënë Shabani disa muaj më parë, kishin shpënë atje vegla e maqineri, «që

të luante tepeleku i kokës». Sidoqoftë, më mirë larg atij vendi.

— Ndoshta s'e ka më atë mëndje, — fliste me vete me një farë shprese. — Iu bënë trembëdhjetë vjet që s'punon atje. Pastaj, edhe ai e ndjen veten të plakur. Do perëndia ka hequr dorë!

II

— Do perëndia, s'e ka më atë mëndje! — mërmëriste prapë të nesërmen në mëngjes e shoqja, ndërsa Shabani si zbriti nga makina mori kodrën në lindje të fshatit, doli te gryka dhe ia mbajti nga miniera.

Ai ecte ngadalë, sodiste vendin me kërshëri dhe përpinqej të zbulonte gjurmat e udhës së dikurshme, shqigjet e monopotet e vjetra. Përrroi iu duk më i ngushtë, monopati që shkurtonte qafën nuk ish më; vende vende, te shtegu i ujkut dukeshin gjurmë bagëtish. Një rrugë e re dhe e gjërë i binte rripës mespërmes, gjarpëronte matanë goricës kryqe e humbiste diku në majë. Vëtëm faqja e përkëtejme nuk kish ndryshuar. Shkëmbenjtë e mëdhënëj e të zinj, që të kallnin datën tek i shihje thua se mbi kokë, si gjithnjë vareshin kërcënonjës e dukeshin sikur do çkëputeshin nga çasti në çast e do të të shembnin.

Qafa e malit i ngallte Shabanit kujtime të vjetra. Brigjet e çveshura i njihte pëllëmbë nér pëllëmbë. Gjashtëmbëdhjetë vjet me radhë kish shkelur mbi to, kish kaluar në piskun e vapës e në dëborë, në shi e në mjergull. Kërkoi me sy te

çuka e vogël, matanë se cilës shtrihej lugina e minierës, lisin e d'egur nga rrufeja. Mezi e gjeti. Nga pema e dikurshme kish mbetur vetëm një copë trung i kalbur e i nxirë. I u afrua i mallëngjyer. Ai dru i nxirë, që mezi binte në sy, e shpuri në një botë tjetër e i kujtoi rishtas vjetët e kaluar. Te ajo pemë qe çlodhur sa e sa herë kur kthehej nga miniera në shtëpi, te ajo pemë kish mallkuar kushedi sa herë fatin e tij të zi dhe kish rënkuar nga kapitja, uria e thellimi.

Majori ndjeu në dorë paketën e cigareve. E kish nxjerë nga xhepi pa e kuptuar, siç nxirte dikur aty qesen e duhanit. Para syve po i ringjallej koha e shkuar. Te lisi kish qëndruar edhe kur kish vajtur për të parën herë në minierë. Kjo kishte ndodhur shumë kohë më parë, aqë sa i dukej si ngjarje që si përkiste më jetës së tij, ndonse i kish të gjalla hollësitë e asaj dite...

* * *

Sa po i kish mbushur të katërmëdhjetat, qe akoma i mitur, fëmijë që s'ngopej tërë ditën se luajturi me cingël, së ngrituri gracka për zogj. së hedhuri kollotumba në kashtën e lëmënjeve. Ishte i sertë. Shpesh kthehej në shtëpi me poturet copë — copë, me ballin tërë xhunga e hundët gjak.

— Gjene qenka zënë, more nikëmath? — e qortonte eëma. — Më hëngre shpirtin! Pse, mor bir, bën kështu?

Shabani s'fliste, pa hedhur më parë sytë te vatra — se mos qe kthyer i ati nga konaket e beut e kur s'e shihje atje, i kthehej s'ëmës:

— Pse më shajnë?

— E ç'të thonë?

— Yaaa, rreckamani i Lavdarit, që fle në haur të gomarit!

Të qe ndonjë e sharë tjetër Shabani do ta kish bërë veshin shurdhër. Po ato fjalë fyenin të atin, që ai e donte shumë. E fyenin sepse, siç kish dëgjuar, ashtu edhe kish ngjarë. I ati pat ardhur vërtet nga Lavdari; kish braktisur shtëpinë që i ri e kish kaluar nga Mborja me një gunë të vjetër e me një sopatë. Kërkonte punë, çfardo lloj pune. Në fillim fshati s'desh ta pranonte, pastaj u pajtua hyzmeqar te konakët e Ibrahim dhe Ali beut. Sa për të fjetur, i dhanë një shkor-së vrima vrima dhe e vunë në një haur, ku mbanin dikur një gomar të kuq e të madh sa një mushkë, që ja kishin sjellë beut të madh nga Misiri. Dhe fshatarët, që i ndruheshin forcës së tij, e shfrenin dufin duke i pëshpëritur pas krahëve:

— Ç'e zini n'gojë Rizanë, rreckamanin e Lavdarit që fle në haur të gomarit!

Pas ca vjetësh ai bëri një shtëpi. E ndërlroi kur afroi koha të martohej me nusen që ja kishin zënë në fshat njerëzit e konakut të beut. Posht'e lart thoshnin se ajo ish «ternene» nga mëndja dhe një herë në dy ditë e zinte sëmundja e tokës. E fshati fliste:

— Shumë e ka edhe atë për në haur.

Këto fjalë i ranë në vesh Rizait. Nuk i erdhi aqë rëndë për sëmundjen se sa për mëndjen e saj çyryk e për punën e haurit. U xhindos e, si kokë-krisur që ish, i hyri Ibrahim beut tek flinte me të shoqen mu në konak të gjumit. Se ç'u fjalosën e si e rregulluan s'e mori vesh njeri. Veç tri ditë më vonë, Rizai, me hajvanët e beut, solli qeres-

tenë nga mali i Drenovës, mblođhi gurë në Drenicë dhe ndërtoi në një kënd të fshatit shtëpinë tij, një si plevicë të madhe me një ashek të vogël pas. Fshati u çudit, e ë u çudit më shumë ditën dasmës. Nusen ja sollën nga dreka, po pa u ngrysur mirë, Rizai thirri një plakë të mëhallës e një tjetër nga të konakut të beut dhe e përçolli nusen tek të sajtë. Asnjeri nga të beut s'e hapi gojën + thosh gjysmë fjale.

— Ja kanë nevojën, — pëshpëritnin fshatarët. — E ku do gjejnë më punëtor e më të krisur se ai! Pa të shohim do gjejë nuse tani?

Po Rizai e gjeti nusen. Një ditë, pa pritur pa kujtuar, pa e marrë vesh njeri, pa mbleskë fejesë, e pruri vetë në shtëpi. Ai ecte përpara mbante një sepë të vogël në supet e tij të gjërrë. Pas tij, kokë ulur, me një bohçe në duar dhe skuqur në fytyrë, vinte gruaja. Ishte një shërbëtore e ve. E njoihu në Korçë, në shtëpinë e një miku të beut, ku shpinte drutë e dimërit. Në fillim e ndihmoi të zbriste kërcunjtë e mëdhenj në bodrum, pastaj e ndihmoi t'i çante, e ndihmoi punët e tjera të rënda dhe, ndonse rrallën e hapte gojën, ja mbushi mëndjen dhe e solli në Mborje.

Vitet kalonin. Rizai ropëtohej tërë ditën në mal, në ara e në vreshta, në minierë për të ngarkuar qymyrin e për ta shpurë në Korçë te furra e Baçeve (se minierën e kishin zotërit e tij me ca të tjerë nga Korça). Veç në shtëpi kthehet me qejf. Atje e priste zjarri i ndezur, çorba ngrohët ose përsheshi me dhallë, e priste gruaja, Shabani i vogël e, pastaj, fëmijët e tjerë. Megji-

thatë, në fshat kish akoma nga ata që i përshpërisnin nga pas:

— Yaaa, rreckaman i Lavdarit, që fle në haur të gomarit!

Fëmijët aq donin. Dhe kur Shabani i vogël u fitonte arrat ose ashikët, ata mernin hak me ato fjalë. Djaloshit i hipte gjaku në kokë, e me që s'i kishte lënë gjë mangut t'et, turrej si i tërbuar pa pyetur fare për numrin e kundërshtarëve dhe nuk shqitej gjersa ja bënин teshat copë e çikë, gjer i mbushej koka me xhunga e i dilte gjak nga hunda. Në këto përleshje më shumë merrte se jepte; por, po ta shaje, përsëri turrej. Në fillim e pati pisk, se të tjerët e mposhtnin lehtë; më vonë vuri mënt. Ndonëse sulmonte si dem i tërbuar, ai mbërthehej vetëm me njerin dhe, me gjithë grushtet e shqelmat që hantë nga të tjerët, e zhdëpte aqë shumë atë që kish nën vehte sa që ky s'guxonte më ta shante; bile, inatin e drurit që i jepnin të tjerët tek ky e nxirte. Kjo e shpëtoi. Dalngadalë kundërshtarët u rralluan, vërsnikët zunë t'ja dëgjonin fjalën e ta kenë mbi krye. Dhe tërë ditën e bekuar haheshin se kush do të hipte më lart në pemë, kush do të hidhej më lart nga trarët e plëvicave, të kalonte natën përmes varreve, të nxirte nga hundët tymin e duhanit prej push dëllinje pa u kollitur e teshtitur, të këndonte hiqendinë si hoxha majë minares së fshatit, e qeshnin e gajaseshin...

Po kjo jetë çapraze e pa andralla nuk zgjati shumë. Në shtëpi u shtuan gojët e, kur Shabani mbushi trembëdhjetë vjeç, u bë me dy vëllezër e një motër.

Një mëngjes i ati i tha:

— Si do ja bëjmë, bir?

— Çfarë?

— S'na del...

Që s'u dilte, Shabani e shihte përditë; e ndjente, sidomos, në mbrëmje kur binte te postiqja afër vatrës me barkun bosh. Mos kish ndërmënd i ati ta fuste në punë? Sa mirë! Do shpëtonte nga shkolla që ja kishte sjellë majë hundës, se gjatë pesë vjetëve, dy herë kish mbetur në klasë; do punonte si të mëdhenjtë e do ta kish xhepin me para... Me to do të blinte një palë opina me xhufka nga ato të Bilishtit, një bilbilkë, një brisk të madh, një kuti duhani e çakmak prej kallamidheje me zinxhirë, si nipi i Ali Baçit. Vëllezërve do t'u blinte këndezka te «Gega», motrës rruaza. Pastaj do t'i binte fshatit poshtë e përpjetë, ta shihnin shokët sa i zoti ish. Në xhep do të mbante edhe sheqerka, nga ato ngjyra-ngjyra, që shiste Kici te pazari i Korçës për pashkët e mëdha, e do të qeraste shokët. Më shumë do t'i jepte Novruzit e Hyskës, se ata nuk i kishin thirrur kurrë «Yaaa rreckamani i Lavdarit që fle në haur të gomarit!»

— Hë, bir, ç'thua? — e pyeti prapë i ati.

— Ku di umë! — ngriti supet Shabani.

— Sikur të futesh gjëkundi?

— Në punë? Posi...

Zemra e djaloshit nisi të rrahë me forcë e mëndja t'i fluturojë gjene te sheqerkat që shiste Kici në Korçë ditën e pashkës së madhe.

I ati heshti një copë herë, pastaj foli me zë të ulët:

— Vete në minierë?

— Hë?!

Shabani shtangu e sytë iu zmadhuang nga hutimi. Kjo s'i kish shkuar ndër mënd. Në minierë punonin të mëdhenjtë, burrat e martuar si Rama, Xhezoja, Novruzi që hynin në bark të malit nëpër ca vrima të vogla si ato të urithit. Të futej edhe ai në errësirë!... Brrr! djaloshi u drodh. Jo, në bark të malit s'mund të hynte. Kushedi ç'gjarpërin: do të kish atje, gjarpërij të zinj, ne-përka, shigjetëza nga ato që fishkëllejnë e vërtiten si plumb. Apo ta zinte mali brënda, siç kish zënë Muharremin. Jo, or jo!... Asnjë moshatari tij s'kish vajtur në minierë. Po, vërtet asnjë moshatar s'kish hyrë atje... Demek, ai do ishte i pari që do të shihtë gjërat e çuditëshme të nën-dheut. Eh, eh, kur të kthehej në mbrëmje e t'u fliste shokëve për vrimën e urithit, naaa do e çapëlenin gojën nga habia. Hë de, le të mburrej po të donte Safeti, nipi i Baçeve që pralliste téré ditën: jo kam parë peshk me yj të kuq në kurriz, jo kam hipur në tromopil në Korçë, jo i kam rënë me dorën time «tytytysë» prej llastiku, jo kam parë një kuti që këndonte si njeri dhe u binte vetë sazeve... Po në bark të malit a kishte hyrë? Jo. Kurse Shabani do të futej, në mes të errësirës... Mirë xhanëm, po pse në errësirë, si në varr. S'ka ndonjë vend tjetër?...

— Po bir, në minierë, — përshpëriti i ati,
— ku të vesh gjetkë?

Shabani uli kokën e u përgjegj «mirë» me zë aq të ulët sa dhe vetë mezi e dëgjoi. Térë ato ditë mëndja i punoi te miniera. Rënqetëhej sa herë e kujtonte, por nuk donte të dukej frikaman. Me ç'sy e faqe do t'u dilte shokëve kur ta merrnin vesh se trëmbej?

Kështu, një mëngjes, at e bir muarën kodrën sipër fshatit, dolën të gryka dhe ia mbajtën nga miniera. Matanë qafës te lisi i djegur nga rrufja, qëndruan një copë herë. I ati mbushi çibukun. Shabani shihte me kërshëri brigjet e çveshura rrëth e rrotull. Babai sosi duhanin, shkundi çibukun, u ngrit dhe i tha të birit:

— Ja, miniera.

Djaloshi hodhi sytë nga lugina e vogël, që shtrihej poshtë tyre. Edhe atje faqet e briave qenë të çveshura. Vetëm nga kreua i luginës dukej një pyll me bredha e shkëmbijtë ngriheshin njeri më lart se tjetri.

— Ku? — pyeti me ndrojtje.

— Ja, mor bir, te bregu afër grykës.

Djaloshi vërejti përsëri. Te bregu rrëzë malit, afër grykës më shkëmbinj të thepisur, mezi dalloj një njollë të errët e në mes të saj një pikë të zezë, tamam si vrima e urithit. Ajo pasqish qenë miniera?! Shabanit iu bë lëkura mornica-mornica. Vrima e zezë në luginën e heshetur midis maleve, i kalli datën. Atje brenda do ish vrarë Muharremi. C'rrëmujë u bë atë ditë në fshat! S'mbeti njeri brenda në shtëpi. S'ish ngrysur akoma kur erdhi mandata nga miniera:

— Dëgjuat, more! — thirri njeri që nga çezm e xhamisë, duke i nxjerrë fjalët me mundim nga lodhja e madhe. — Ra mali dhe i zuri burrat brenda!

— Korbani ç'na gjeti! — ia dhanë kujës gratë e dolën nga shtëpitë sic ishin.

Të mëdhenj e të vegjël muarën grykën. Gratë rendnin si të çakërdisura, coptonin faqet e ç'fliste njera, s'fliste tjetra.

— U vranë brenda, — thoshnin ca.

— Të gjithë? — pyesnin të tjerët të zverdhur si limoni.

— S'dihet: po ata që punonin brenda, atje do kenë mbetur.

— Të mjerat ne!... — qanin gratë.

Njerëzit rendnin përpjetë grykës, rrëshqisnin te rripa, rrukullisëshin poshtë, po gjene ngriheshin e rendnin prap, duke hapur gojën që të ngopeshin me fryshtë.

— Ka dalë ujët dhe i mbyti... .

— Jo ujët, u shëmb vendi... .

Vargu i fshatarëve zgjatej te rripa e grykës. Gratë, me shamitë e kokës në duar e me sytë të çakëritur dihasnin me të madhe, vraponin pas burrave e lëshonin lotë pa nxjerrë zë. Në udhët e fshatit fëmijët e braktisur qanin të trembur e me lebeti.

Te qafa u duk një që vinte nga miniera. Ai qëndroi te gorica kryqe, vrejti vargun e njerëzve dhe ia dha me sa fuqi pati:

— Kthehuni, kthehuni! Vetëm njeri ka mbetur brenda.

— Kush?

— Folë, Lipe!

— Të keqen, o Lipe, thuana!... — thërrisin fshatarkat me zë të dredhur.

Njerëzit qëndruan dhe pritën në heshtje, me ank h e tmerr, të dëgjonin mandatën. Gjokset e tyre uleshin e ngriheshin me të shpejtë, djersët u kullonin rrëke, zemra mënt u çante gjoksin. Prisnin të dëgjonin kobin.

— Muharremi, Muharremi i Nurçes, — thi-
rri Lipja dhe shtoi: — Të tjerët shpëtuan. Nja
dy janë plagosur lehtë. I shpëtoi... .

— E zeza unë!... — klithi e shoqja e Muharremit sa nuk u dëgjuan më fjalët e Lipes. Ajo ra përmbyss, nisi të çjerë faqet e të çkulë leshrat — Ç'na bëre Remkë, po ne ku na le!... Ku t'i mbytem unë me fëmijë... Pse s'na more edhe atje brenda, o Remkë!...

Të vrarin e nxorën pas katër ditëve dhe e sot llën në fshat, po në shtëpinë e tij kuja nuk puthoi as pas dy javëve, e Shabanit se si i bëhej nuk bark kur dëgjonte të qarat e kur kujtonte trupin e zi e si kërcu të Muharremit, që e pa prapa gardhit kur e shpunë në shtëpi. Thoshnin se i qenit thërmuar tërë kockat, se një gur i math ia kish bërë gjoksin petë. Ato ditë ai dëgjoi nga të mëdhenjtë shumë ngjarje të kobëshme. Rama tregonte për kohën e francezëve; se një farë Shuaip nga fshatrat e Kolonjës, kish mbetur brenda ngrëni; bile, e kishin mbyllur tërë galerinë. Rama e mbante mend fare mirë si kish ngjarë, se ai punonte që atëherë në minierë. Tregonë pastave se kur erdhën të afërmit e të vrarit që ta kërkonin, ata «mushjutë», siç i quante Rama francezët, u bënë si budallenj, sikur s'kuptonin e sikur s'njihnin ndonjë Shuaip, se ajo galeria e tyre qenkish mbyllur shumë kohë më parë. Dhe i vdeku kuri kish mbetur atje...

— Bobo! — mendonte Shabani i tmeruan teksha shihte luginën e shkretë e të heshtur të minierës. Në atë vrimë të urithit ku qe vrarë Muharremi, pranë Shuaipit të vdekur kërkonin tafutnin edhe atë! Oh, pse po e dërgonin në atë varr, ku njeriu vdiste dhe e linin vetëm brenda!...

Djaloshi ktheu sytë nga i ati me vështrim lutës.

— Do perëndia të marrin në punë! — mërmëriti ky dhe zuri të zbresë poshtë bregut, në luginën e minierës.

Në fund të luginës, rrëzë një gropë, panë një barakë. Shabani zuri të qetësohej, po kur qe pranë ndërtesës desh u hodh përpjetë nga frika, e, të mos i kish shtërnguar dorën i ati, do ia kish mbathur me të katra. Afër derës së barakës qenë ulur dy «të zinj». Qenë të zinj kokë e këmbë, vetëm sytë rrotull bebëzave u zbardhnin e u duke-shin të mëdha sa një filxhan.

— C'e solle këtë kërrthijë, o Riza — foli njeri prej tyre. — E paske edhe të dobët!...

— Qenkan njerëz! — tha Shabani me vete dhe i vuri re më me guxim. Ishin të leckosur e të mbuluar krejt me blozë qomyri. Pluhuri i zi u kish hyrë gjer te rrudhat e fytyrës, në vrimat e veshëve e në feçkat e hundës. — Si duket do të kenë qenë te vrima e urithit.

I ati nuk u përgjegj menjëherë. Eci ca çape me vetulla të ngrysura e qëndroi pa pritur.

— Do ketë, vallë, ndonjë copë vend pér këtë? — i pyeti si nëpër dhëmbë.

— Hyrë, mbase vogëlushi ka kësмет, — ia ktheu njeri nga ata.

I ati u fut në barakë. Shabani, si pulë e shushatur, vijoi të shohë «të zintjtë», po këtë radhë pa frikë.

— Si ata do të bëhem edhe unë, — zuri të mendojë. — Do dukem arap, s'do më njo'hë njeri, s'do më njo'hin as shokët. — Shabanit i hipi e qeshura: — Kur t'u dal, pa pritur, prapa gardhit

e t'ua bëj: huum, huum! oh sa do të tremben
Jo, do bëj ndryshe: do fshihem prapa varreve
ndajnatëhere e do t'i dërgoj haber Safetit të vije
andej se kam gjetur një breshkë me dy kokë
Kur të afrochen pranë varreve, do gérhas si derr
grrr, grrr, pastaj do ngrihem, do hap krahët e do
u kanosem duke u thirrur me zë të trashë:
Qëndroni se u hëngra!... — Ata do ua japin
këmbëve e do bërtasin të lebetitur: Lugati, lugati!
Eh, ç'do qeshim!...

Shabani s'priti shumë. I ati doli nga baraka
i zymtë.

— S'bëmë gjë sot, — pëshpëriti. — Duhet të
vímë nesër.

— Shyqyr! — tha më vete djaloshi i gëzuar
As të nesërmen s'rregulluan gjë. Vetëm kur
u kthye Ali Baçi në fshat, i ati mundi t'i sigurojë
një vënd. Atë mëngjes, duke dalë nga baraka,
babai vuri dorën e tij të rëndë mbi kokën e të
birit e i tha:

— Të morën. Do punosh me Ramën në Tha-
nasicë e do të paguajnë tri lopka¹⁾.

— Për çdo ditë?

— Jo, për çdo njëqind okë qymyr.

— Kaq merr Rama?

I ati u ngrys e nisi t'i rrähë damari i ballit.

— Të mëdhenjtë marrin më shumë.

— Pse?

— E dinë që nga halli i sjellin fëmijët në
punë. Kështu është kur je ngushtë: nga hiçja be-
reqaversen edhe tri lopka! Nesër fillon nga puna.

1) Lopkë quanin në krahinën e Korçës një të katë
tën e lekut.

Ditët e para qenë shumë të rënda. Kur u fut në galeri dridhej i téri. Era e mykut që vinte nga barku i dheut, ujët që i kullonte papritur herë në kokë, herë në qafë, herë në trup, ia rrënqethnin mishtë. Pastaj zuri t'i dhimbte mezi nga të ecurit gjermuq, t'i buaviteshin e t'i gjakos shin këmbët nga të ecurit zbathur në ujë e mbi gurët e mprehtë, t'i dhimbnin gjunjët e brylet nga të zvarrisurit. Po të gjitha këto duroheshin ndaj errësirës e zhurmave të çudiçme që vinin nga brenda malit. Nganjëherë i dukej sikur qe vetëm, sikur të tjerët e kishin braktisur në atë varr të thellë e ja kishin zënë vrimën e daljes. Hera herës, oshëtima e mbytur e kollës së ndonjë minatori, që punonte më tutje i bëhej si zëri i ndonjë xhindi. Kish edhe raste që i dukej se Shuaipi i vdekur kish ardhur në galerinë e tij. Një ditë, llamba e vogël iu shojt pa pritur e një erë e rëndë që të mbyste mbuloi vendin ku punonte. Shabani ngriu nga frika. Ca zhurma, si të ecurit lehtë të ndonjë hajduti, zunë të ndiheshin pranë, të afroheshin pérherë e më tepër. Zemra djaloshit sa nuk i coptonte gjoksin. Diçka fare afër krisi. Shabani klithi i tmeruar e mbeti me sy të zgurdulluar e gojën hapur, duke pritur ta rrëmbenin kthetrat e të vdekurit.

— Ç'pate, Bame? — i thirri Rama dhe i erdhi pranë.

Shabani e mblodhi veten. Rama s'e paskish braktisur; ja ku qenkan edhe të tjerët. Djaloshit i erdhi turp që klithi. Ç't'i thosh tani Ramës?

— Mos u vrave? — e pyeti gjene ai, duke ndjerë dihatjen e një farë ngashërimi te frysëmarrja e djaloshit.

— U vrava të gjuri, — pëshpëriti Shabani me një fije zëri.

— Të doli gjak?

— Jo, jo.

— Do të të shkojë... Dal të ndez dritën...

— Ohu, sa herë jemi vrarë ne! Rri, rri, mos lëviz. Çlodhu ca... Nema rabën tënde të ta mbush me qymyr...

Dalëngadalë u mësua në minierë. Po u dha më shumë pas punës kur i ndodhi mënxyra në familje. Zija i pllakosi shtëpinë. Brënda në vrimën e urithit sikur e harronte dhëmbjet kurse në shtëpi i copëtohej zemra. Dhoma e hesh'ur; pa zérat e gëzuara të vellezërve e të motrës i dukej e zezë, e shkretë, varr. Shtrojet e tyre s'qenë më rrëzë murit, lodrat e tyre: cinglat, ashiket, e llastikat e zogjve s'qenë më sipër vatrës, nëpër kamarret e prapa derës. Ia këpuste shpirtin e ëma. Për natë e gjente pranë zjarrit, mbledhur grusht me kokë përbys. Dhe i ati strukur te vatra, s'hapte gojën fare. Ai trazonte or'e çast urët me mashë e i afrohej më shumë kllanikut, thuajse flaka e drurëve s'ia ngrohte dot trupin e shpirtin e tij të plagosur rëndë.

Me kohë plaga zuri kore e bashkë me vitet që rrukulliseshin edhe dhëmbja platitej. Shabani që e ndjente se ishte shpresa e vetme për dy pleqtë mundohej t'u lehtësonte dhëmbjen duke qenë sa më i bindur dhe i matur. S'ishte më i vogël!

Pëkur u kthyë nga ushtria erdhi në shtëpi i zemëruar se i ati i kish zënë nuse në Vinçan.

— Prishe fejesën! — i tha plakut që atë mbrëmje.

— Pse, mor bir, s'do të martohesh? — iu përgjegj ai i lënduar nga ato fjalë.

— S'e s'jemi ne për martesë. Mos ma zini më në gojë këtë punë.

E ëma i mori dorën e ia shtrëngoi në gji. Lotët e saj zunë të pikojnë mbi të.

— Të keqen nëna, Bame; pse do të na e mbyllësh shtëpinë? Mezi të pritëm sa mbarove ushtrinë. Vetëm ky gjëzim na mban akoma gjallë.

Nusen ditën e dasmës, e priti me zemër të thyer. Kur mbeti në dhomë vetëm me të, Shabani s'bëri zë një copë herë. Gruan s'e kish parë kurrë gjer atë ditë. E ja, tani ai qe vetëm me të. Se si i vinte tek rrinte në një dhomë me një femër. E vuri re vjedhurazi. Iu duk e vogël, si fëmijë. Ajo do të ish gruaja e tij, me të do ta kallonte jetën.

U mat nja dy herë të fliste, po tek e shihte të struktur te këndi, me kokën ulur nga turpi e duke u dredhur, u ndrojt. Ndoshta ajo s'e dinte sa keq hiqnin te shtëpia ku e sollën, as e dinte se burri qe i dhanë merrej me një punë aq të rëndë, aq me rrezik...

— Dëgjo, moj motër, — i bëlbëzoi nuses duke iu afruar e duke u munduar të fshihte dridhmat, që edhe atij po i përshkonin trupin.

Nusja u mblodh akoma më shumë.

— Mos u tremb, — u përpooq ta qetësonte Shabani dhe u ul pranë kllanikut.

Fjalët që pregetiti t'i thosh pak më parë, iu ngatërruan:

— Unë... dua tē them, ti... E di si?... Dëgjo: ja, këtë kasolle kemi vetëm... Unë punoj në minierë, po nuk paguajnë shumë, — goja sikur iu çlirua dhe vijoi tē flasë duke parë zjarrin: — S'dua tē tē marr më qafë. U thashë pleqve tē mos më martojnë, se s'ja kemi vaftin; po ata s'deshën. Kanë edhe hak, se janë përvëluar. U vdiqën tërë fëmijët e mbetën vetëm me mua. Ndaj tē them, po që se në shtëpinë tënde je më mi-rë... mendohu. Këtu do heqësh keq.

Ktheu kokën nga nusja.

Ajo e vështroi një çast me bisht tē syrit, zuri tē dridhej e sytë iu mbushën me lot. Shabanit i erdhi keq dhe s'dinte ç'të thosh:

— Unë s'të pérze, — i tha pas pak, — as kam gjë me ty. Po dua ta dish tē vërtetën.

— Ky... ky qe kësмети im, — nxori ajo një fije zëri dhe i shpërthyen lotët.

Sa herë e kujtonte këtë bisedë ai ndjente një ndrydhje në zemër e i vinte turp.

Një mbrëmje, e ëma kish dalë dhe e priste në udhë...

— Erdhe, tē keqen nëna, — i foli ajo.

— Ç'rri te porta?

— Hyrë brenda, hyrë, — dhe i ra krahëve.

— Shyqyr o perëndi, shyqyr.

— Ç'flet kështu, moj nënë, ç'është ky shyqyr?

— E shejtan, edhe njëditzaj tē pyeta, pse s'më the se do bëhem gjyshe?

Atë natë Shabanin mezi e zuri gjumi. Nuk e kuptonte as vetë ç'kishte. Një si ngazëllim e kish pushtuar. Herë pas here vështronte i ma-

llëngjyer të shoqen, që flinte pranë, me gërshe-
tat të çpleksura.

— Sa i lik u tregova atë natë, — qortoi ve-
ten — Kush e di sa ka vojtur kur i dëgjoi ato
fjalë, — dhe duke ia ngritur kryet me kujdes i
vuri jastëkun nën të.

Muajt mezi iknin. Tani ai kthehej në shtëpi
me një frymë dhe ulej te vatra karshi të jatit.

— Ndize një herë, — e ftonte plaku, duke
i dhënë kutinë e duhanit.

Kur hynte e shoqja në dhomë, Shabani bën-
te sikur s'e shihte se i vinte rëndë në sy të t'et,
po plaku nuk e fshihte dot, gëzimin dhe e vësh-
tronë me dashuri.

— Ç'e ngre sepeten, moj e uruar, — i fliste
së resë me zë të trashë. — Apo të na bësh ndonjë
të pabërë!... — Pastaj i thërriste së shoqes që
punonte në ashek: — Moj ti, i ke mëntë në ko-
kë, apo jo! Sa herë të kam thënë!

Një natë Shabani po kthehej i nxituar nga
puna e s'i vuri re nja dy gra që qenë në oborr.
Kur deshi të hapë derën, njera i thirri:

— Prit, Bame, ku vete?

— È? — minatori mbeti si i ngrirë me dorën
te doreza e derës. — Pse?

— Të të rrojë djali, me këmbë të mbarë!

Shabani hapi sytë, gjunjët iu prenë dhe një
afsh i ngrohtë ja skuqi fytyrën.

— Kur? — pyeti me gjysëm zëri.

— Qëpari. Reshideja akoma s'ka mbaruar
nga të sajat. Ikë në ashek!

Në ashek plaku vinte rrrotull. Me të parë të
birin hapi krahët.

— Të na rrojë, bir!

Shabani e përqafoi si i ngrirë. I vinte turp nga i ati e nga që s'dinte si të sillej, u ul te minderi dhe heshti.

Shabani ra të flerë në ashef me plakun. Po s'mbyllte dot sy. Mendja i punonte te e shoqja dhe tek i biri e një dëshirë e zjarrtë e shtynte të shihte foshnjën e gruan. S'i durohej gjer të nesërmen, po i vinte zor të hynte në dhomë në sy të s'ëmës. Mendime e ëndra nisi të thurë atë natë, duke vënë veshin se mos dëgjonte të qarët e djalit.

— Iu bëftë nëna, — u dëgjua plaka, që vinte gjymin në zjarr.

Plakut i shkëlqyen sytë.

— Eja bir, të shohësh djalin, — i tha pa pritur e ëma.

— Hëm! — u kollit plaku dhe u ngrit më parë se Shabani.

Nusja mbylli sytë posa u dhanë te dera i vjehri dhe i shoqi, e me marifet ngriti buzën e mbulesës dhe e hodhi në fytyrë. I vinte rëndë që e panë të shtrirë. Shabani e kuptoi dhe vuri buzën në gaz. Pranë saj, mbështjellë me pelenka leshi, qe vendosur foshnja.

— Ptu, ptu, ptu! Ukubet, ukubet i Zotit është, iu bëftë nëna! — pëshpëriste plaka duke ngritur cepin e pelenkës.

— Rrofsh, moj nuse! — foli plaku e shtrëngoi duart e veta në gjoks, si fëmijët kur gëzohen nga ndonië peshqesh i dëshëruar prej kohësh.

— Nuk shikon, sikur kushedi c'ka bërë! — ia priti plaka, mbuloi gjene foshniën dhe shtoi: — Fare ukubet është, guguçe e nënës!

— E, moj, — ia pat ai i pakënaqur nga që s'e pa mirë. — Ne jemi të shtëpisë e s'e marrim më sysh, po hape ca ta shikojmë.

— Ikni tani, se kemi punë, — iu përgjegj me ton gazmor plaka dhe iu drejtua të shoqit: — Ti sill dru nga mali, se na duhet zjarr pér foshnjen!

— Mos harro nusen, moj. Jepi të hajë ndonjë gjë të mirë.

— Shko, shko në mal e na sill ca dru, atë shiko ti! — u dëgjua zëri i plakës nga brenda.

Shabani e ndjente veten të lumtur. Punonte me fuqi të dyfishuara, e mezi priste mbrëmjen që të kthehej në shtëpi, te i biri. Më të shumtën e herës e gjente në gjumë, po kjo s'ia pakësonte aspak ngazëllimin. Mjaft që e shihte tek flinte, që shihte se si i skuqeshin faqet e i lëvizte duart e njoma, që ia dëgjonte zërin kur qante. Kur ulej te kllaniku i kënaqej shpirti tek dëgjonte të atin e t'ëmën që i flisnin pér të duke ja rrëmbyer fjalën njeri tjetrit. E ky gëzim e zhyste në një botë ëndrash, që i ndillnin një kënaqësi, të cilën s'e kish ndjerë kurrë më parë. Ky qe gëzimi i parë në jetën e tij.

* * *

Majori hodhi cingaren, u ngrit nag trungu dhe mori tatëpjetën pér në minierë. Kur doli te bregu i fundit, qëndroi dhe hapi sytë. Lugina s'njihej fare. Ajo qe mbushur me dërrasa të mëdha e të vogla që zbardhonin më shumë pranë bunkerëve të zinj të qomyrit. Afër godinës së gjatë dykatëshe të kinemasë shtrihej një lulish-te e zbukuruar me plisa të gjelbër e tulla të ku-

tilografë, nëpunës të tjerë. I shtrëngonin dorën me ngrohtësi dhe uleshin, duke e parë me vërejtje.

— Të gjithë të rinj, — thosh me vehte Shabanë.

— Qënke kthyer, Thimi? — e pyeti njeri minatorin e vjetër. — Si dole, ia mbushe mëndjen?

Thimi tundi kryet dhe foli nëpër dhëmbë.

— Jo, nuk e marr vesh punën e këtyre të rinjve, — dhe, si iu kthye Shabanit, shtoi: — Kemi qenë edhe ne të rinj, po kështu si këta të sotmit s'kemi bërë. E kuqtoj, dashuria është hall i madh kur të zë, të bën të vuash e ku di unë çfarë, po që të braktisësh minierën për hatër të saj, si bëri Fatriu, këtë s'e kuqtoj dot.

Shabani ngriti supet; nuk e dinte s'e ç'kishte ngjarë, dhe priti që Thimi ta sqaronte. Po minatori i vjetër heshti.

— Ç'bëri ky Fatriu? — pyeti Shabani më në fund.

— Lere mos e pyet, — çfryu Thimi. — Punganonte mirë e bukur e do të bëhej minator i hatashëm, sikur të mos ia kish marrë mëndjen një balukeprerë andej nga Elbasani. I hypi në kokë dhe me rast e pa rast shkonte atje. Kohët e fundit iu tipos se prindërit e saj do ta fejonin më një tjetër dhe na braktisi.

— Nuk iu tipos, po ishte e vërtetë. Prindërit e saj do t'ja jepnin tjetër kujt, — e ndërpree një nga vajzat që i rrinte pranë.

Thimi e pa vëngër:

— Dhe të braktiste minierën, ë?

— Ai nuk e braktisi, po kërkoi të transferohet në Krrabë, që ta kish pranë të fejuarën, gjer-

sa ajo ende nuk qe pregititur për dasmë; pastaj Fatriu kérkon ta rregullojë me të mirë qoftë me prindërit e saj, që s'duan ta kenë vajzën larg tyre, qoftë me prindërit e tij, të cilëve nuk mund t'u vijë në ndihmë po qe s'e vendoset me të shqen këtu, larg Elbasanit.

Thimi bëri sikur nuk i dëgjoi fjalët e fundit të vajzës dhe iu kthyeshabanit:

— Do bëhej minator shumë i mirë, Shaban. E kisha marrë unë në patronazh dhe, nga që më erdhi inat, shkova vetë gjer në Elbasan që tia mbushja mëndjen e të kthehej. Ç'e do; kot sa u lodha! Ja, kështu këta të rintjtë, — e mylli bisedën minatori i vjetër duke bërë përsëri veshin e shurdhër ndaj fjalëve që po thosh një djalosh i ri:

— Edhe në Krabë ai do të bëhet minator i zoti. Po ty, xha Thimi të vjen keq kur ndonjë punëtor largohet nga kjo minierë.

— Shokët tanë si venë! — ndërroi muhabetin Shabani.

— Nasi e mbaroi turnin e tij. Do të ketë zbritur në shtëpi. Xhoxhi është në galeri, Ramën s'e pashë gjékundi.

— Ja ku po vjen — shtoi sekretari si pa nga dritarja.

Shabani ngriti perden dhe e dalloi që larg. Trupi i madh i Ramës binte në sy në mes të gjithë njerëzve që ecnin pranë tij. Ekte pak i krusur e lëviste duart teksha bisedonte me një tjetër. Dukej se nuk qe i një mëndjeje me shokun përbri sepse herë pas here hapte krahët e tij të gjatë si të donte të thoshte: «Ej, mor zot» dhe hera herës e shihte pak si shtrembër me vetullat

e ngitura. Shabani vuri buzën në gaz. Ajo shprehje e fytyrës së Ramës që tepër e njohur për të. Me siguri në atë çast ai thoshte: «Ke parëti». Deri sa i erdhi pranë ndërtesës së drejtorisë e pa tjetrin shtrëmbër mjaft herë, pastaj, ngjeshi shapkën e minatorit dhe shpejtoi hapat i zemëruar.

Kur hapi derën dhe pa Shabanin, përpëliti sytë nga habia e ridehu duart përpara.

— Erdhe, Bame? — thirri i gëzuar dhe e shtrëngoi në gjoksin e tij.

Ndërsa Shabani matej t'i fliste plaku rrudhi vetullat, hapi derën dhe futi shokun, më të cilin kish ardhur.

— E sheh shokun major? — iu kthye atij. — Lutju t'u tregojë djemve të tu s'e si i binte bretku nga puna e rëndë, kur puronte këtu. Nxirrte njëqind okë qymyr dhe kryepunëtori ia numëronte për pesëdhjetë. Në fund të ditës i dilte të merrte tri lopka. More vesh? Tri lopka për qymyrin që e nxirrte me thonj e me gjak.

Rama u kollit një copë herë, fshiu ballin e dërsitur dhe vijoi:

— Qymyrin nuk e nxirrte më çizme e mushama siç u kanë dhënë minatorëve sot, as flinte në krevat me dyshek, as bënte banjë me ujë të nxeh-të pas punës, as kish klub e kinema. Kurse ndonjë nga ata të tutë, më dridhet e përdridhet: «Jo, këtu s'bën për mua, jo atje s'rri dot, jo në galleri s'del leku, e rëngë dëngë...»

Tjetri i shtrëngoi dorën majorit, ndërsa Rama s'pushonte:

— Ke parë ti! që posa vinë duan të marrin dhjetë mijë lekë në muaj. Të jenë të zotët, me

shëndet t'i hanë, po hem s'dinë, hem kërkojnë thelën e majme. E kur shohin se dhjetë mijshi qënka kockë e fortë e s'u hëngërka lehtë, përdredhin buzët e s'u rrihet këtu.

— Me zor s'mbahen njerëzit — tha sekretari.

— Ama edhe ti, sekretar — ia pat xha Rama, po në vënd që të vijonte, iu drejtua gjene Shabanit: — Ke parë ti; përherë me të butë ky sekretari ynë!

— Të kuqtoj, xha Ramë. Të gjithëve na vjen maraz kur ikën ndonjeri. Kurse ty, Thimit, Nasit, u vjen të pëlcisni se u duket sikur s'e begenis njëri minierën tonë, — foli sekretari.

IV

Shabani i shoqëruar nga një teknik, mori udhën për nga galeritë.

«Ç'e zë në gojë kohën tonë të rinisë, o Thimi, — foli me vete. — Të ritë tanë e shuajti ky mali dikur. Ja, këtu qe banesa e Ismailit, aty ai kontrollonte rabën time, aty ai e gjysmonte qymyrin që merrja, aty më tha atëhëre, nga vera e tridhjetë e tetës që t'i dilnja shahit se Ilua i shkretë paskish dashur t'i vjedhë paratë në sirtar, ndaj edhe e kish përzënë me xhandarë».

— Shoku major, largohuni nga shinat, se po vinë vagonat! — i bërtit një puntor.

Majori qëndroi: Ish përballë hyrjes së një galerie. Nga brenda u dëgjua tingulli i një këmbane dhe zhurma e rrotave të vagonave. Pak çaste më vonë nga galeria zunë të dilnin vagonat lidhur njeri me tjetrin. Në fund vinte një maqinë, pak më e gjatë se vagonat. E drejtonte një puntor. Me të dalë nga galerija, punëtori lojti një vegël të vogël. Vagonat zunë të rrëshqitnin më shpejt. Tuttje, pranë një ure të drunjtë, pakësuan shpejtësinë, qëndruan bri një bunkeri dhe u zbrazën.

Shabanit iu kujtua përsëri kryepunëtori, Ismaili.

— Ta di se është gjallë do ta sillnja me forcë këtu atë qafir dhe do t'i thoshja: «Shikcje minierën tani». Po kushedi se ku do t'i ketë lënë kockat. Zaten shumë vetë ia kishin bërë benë ta vrisin. Edhe unë i zura pusinë atë natë, që kërkoi t'i dilnja shahit. Pati fat, që s'kaloi nga qafa. Veç ma punoi. Bëri ç'bëri dhe më përzuri nga miniera.

— Do presim pak shoku major, sa të vijë magazinjeri e të na japë teshat, — i tha tekniku.

Shabani u ul mbi disa trarë dhe ndoqi fillin e mendimeve të tij. I kujtohej me hollësi mbrëmja kur u zu me kryepunëtorin. I vinte inat që s'e shembi në dru atëhere. Atë mbrëmje u kthyeshë shtëpi pik' e vrer.

— U qelb puna, — i tha të atit. — E bëri të tijnë, qeni!...

I ati zuri të trazojë zjarrin. Damari në mes të ballit nisi t'i rrahë me forcë. E ëma dhe e shoqja mbetën si të ngrira. Në dhomë u bë një copë here qetësi.

— Ç'do bësh tani? — e pyeti plaku pa kthyer kokën.

— Them të vete në Tiranë. Ilua do më ndihmojë të gjej ndonjë punë. Më ka shkruar edhe një letër.

I ati heshti gjene një copë herë. Shabani pa t'ëmën e të shoqen. Ato qenë mbledhur pas njëra tjetrës dhe po e vrenin të pikëlluara. Ai vëtë rrinte si mbi gjemba. Nuk i pëlqente heshtja e plakut, as fytyra e tij e egërsuar, as vetullat e trasha që i qenë varur poshtë, as flokët e shkurtëra e të bardha që i qenë ngritur përpjëtë. Ia dinte huqet.

— Je i zoti të rrosh maleve? — foli plaku me zë të vrazhët e të ngjirur, pa hequr dorën nga urët.

Shabani picërroi sytë.

— S'të marr vesh.

— Kaçak rron dot? — dhe e pa të birin në sy.

— O zot! — belbëzoi e tmeruar eëma e zverdhur dhe zuri të dridhej. E shoqja vuri dorën në faqe. Shabani kafshoi buzën.

— E mata atë punë që kur kthehesha në shtëpi. S'do vija as të piqesha me ju, po të dilte gjë. Ç'kanë fituar ata që morën malet? Ja e vrava atë qen, pastaj? Do u bien në qafë juve dhe mua ndonjë ditë do ma bëjnë gropën nëndonjë ferrë, kurse atje do sjellin ndonjë Ismail tjetër.

Plaku s'foli.

— S'del gjë, jo! — mërmëriti pas një copë here. — Tërë derrat një turi kanë. Ç't'u bëj këtyrë të tharave që i kam si kërcunj, — dhe shtriu duart. — Eh, ç'kohëra që erdhën, më

hipin në qafë e s'jam i zoti të marr hakën... Mirë, mirë; nisu për Tiranë, mbasë atje punët janë ndryshe.

Atë natë asnjeri nga të shtëpisë s'vuri gjë në gojë.

— Bame, të keqen, — i pëshpëristë me lot në sy e shoqja në shtrat. — Mos e trubullo gjakun. Do Perendia e gjen punë.

— Më vjen keq për ju, pa për mua, dinja si t'ia ndreqja qefin. Ç'taksirat të vuani ju.

— Ç'thuas kështu?

— Jetë është kjo?

— Mos të keqen, mos folë kështu. Nuk jemi vetëm ne që vuajmë. Të gjithë me halle rrojnë. Do ta kapërcejmë edhe këtë, po ikë një orë e më parë që këtej.

Shabani ndjente ngashërimin e së shoqes dhe i vinte keq.

— Ç'të bëj në Tiranë me shtatëmbëdhjetë lekët e mijë dhe me dollarin që ma dha hua Rama? Sa t'ju lë juve, sa të mbaj për vete? Po të gjej punë apo të vete, ua kthej menjëherë dollarin, po s'dihet.

— Merri të gjitha, se ne do të bëjmë si të bëjmë. Do vete edhe unë të vjel misrat me hakë, bashkë me nënën.

— Ti për tre muaj do lindësh, moj e mjerë! E shoqja pshërtiu thellë.

Shabani u suall vërdallë në Tiranë dy javë të tëra. Ngrihej me t'u gdhirë, u binte rrugëve posht' e përpjetë dhe kthehej në pazar të vjetër, ku kish zënë vend, kur bëhej fare natë.

— Ç'vënd pis! — çfryente me neveri.

Pandehte se e kish njojur kryeqytetin kur

bëri ushtrinë, pesë vjet më parë e s'i kish shkuar ndër mënt se do kish lokale kaq të ndyrë mu në mes të Tiranës! Në kohën e shërbimit ushtarëk kish soditur dyqanet e mëdhenj me mallra të kushtueshme të rrugës «28 Nëndori», bulevardin e gjërë me kafenetë lluuksoze, pasticeritë e bukura të rrugës mbretnore. Kish parë edhe leckamanë e lypsa që mbushnin udhët, fëmijë që shisnin kikirikë gjer në mes të natës, ponuk i kishin lënë mbresë të madhe. Më tepër vragë i kishin lënë gratë, që vinin për mëngjes te telat e kazermave, për të nxjerrë ndonjë lek duke larë ndërresat e ushtarëve. Kish nga këto që e bënin këtë shërbim edhe për një gavetë gjellë. I kujtohej një grua e shkurtër e shtatzane që vinte me të dy fëmijët. I kujtohej pastaj tufa e fëmijëve të veshur vetëm me nga një fustan basmje të grisur. Silleshin tërë ditën rrotull sheshit të kazermave e kur ushtarët shpérndaheshin për të ngrënë drekën, ata u afroheshin, uleshin në bisht, u numuronin kafshatat dhe kapërcenin pështymën sa herë që ushtarët fusnin në gojë bukën me gjellë, sa herë gjelltisnin përsheshin me fasule. E ai ushqim Shabanit e shokëve të tij u bëhej farmak, e linin përgjysmë e ua jepnin fëmijëve, fshehurazi nga nënëficeri i ditës. Megjithatë, të tëra këto zbeheshin para drizave shumëngjyrëshe të vetrinave të dyqaneve, para tingujve të orkestrës së kafenesë së madhe të bulevardit, përballë kishës ortodokse. Tek ai lokal Shabani kish parë një mbrëmje diçka që e kish lënë me gojë hapur. Atë ditë kishte marrë shtatë lekë e gjysmë, pagën e tij mujore si ushtar. Kish mbajtur për vete gjys-

më leku, të tjerat ia kishte dërguar të atit oë t'i kish për bajram. E me që kish liri dalje ia mbajti nga bulevardi.

Ngjitur me kafenenë, sipër një porte që piktuuar një maçok i zi, që fekste nga një drithë e kuqe elektrike. Nga bodrumet e kësaj godine dëgjoheshin zëra gazmore dhe muzikë. Dritaret e mbrojtura me shufra hekuri e të zëna me perde të rënda, nuk linin të dukej gjë. Veç në njérën prej tyre, rrëshqiste një vijë e hollë drite; perdet nuk qenë puthitur mirë. Nëpër këtë të çarë të ngushtë Shabani pa një sallon të bukur, dy burra të veshur mirë që hanin e pinin në një tavolinë të vogël e të rrumbullakët. Më tutje dukej cepi i një tryeze tjeter dhe këmbët e shtrira të atij që kish zënë vënd atje. Ushtari përpëliti sytë nga dritat e fuqishme që llamburitnin atë sallon dhe zuri të vrasë mëndjen për të kuptuar se çfarë ish atje. Në atë kohë kaloi përmes sallonit një femër. Ish e re dhe tërrë nur, veshur me një fustan të hollë tyli. Shabani hapi sytë. Fustani ish aq i hollë sa i dukej krejt trupi. Gjoksin e shpatullat i kish zbuluar dhe gjitë nga dritarja pothuaj se i dukeshin të tërë. Ushtari u mahnit e i çakariti më shumë sytë, kapërxeu pështymën dhe një zjarrllék iu shpif në trup. Femra ecte me naze e qeshte. Qëndroi të tryeza që mezi dukej. Tani perdja s'e linte të dukej e tëra, i dukeshin vetëm flokët e kurrizi i saj i drejtë. Dikush nga tryeza zgjati dorën dhe ia vuri asaj nën sqetull. Balli i ushtarit u mbush menjëherë me bula djerse. Femra qeshi me të madhe, përdrohhi trupin dhe bëri një hap prapa, po dora e atij që rrinte

në tryezë e kapi menjëherë nga llëra e zuri të tërheqë pranë vetes. Shabani pa e ndjerë as vettë, zgjati dorën përmes hekurave që të hapte perden e të shihte atë femër, që po i afronej zotnisë, po e pengoi xhami.

— E re, — dikuush foli prapa ushtarit. — Duket gjë?

Shabani u kthyen menjëherë i turpëruar. Pranë tij kish qëndruar një burrë.

— Po bëjnë qejf, ë? — vijoi ai dhe zgjati kokën tek e çara e perdeve.

Ushtari e pa me vretje dhe e pyeti me ndrojtje:

— Ç'është këtu?

Tjetri u ngrit, krojti kokën dhe iu afrua ushtarit:

— Harem evropian, për të englendisur një copë heië ata që kanë verdhushka. — Duke vënë re se ushtari s'kuptoi gjë, shtoi: — Bordell, or bordell.

Shabani gjene s'mori vesh.

— Duhet ta kesh xhepin plot me napolona pa të hysh. Vetëm kafeja kushton dy franga ar.

— Ikë more!... — thirri ushtari i habitur.

— Pse kaq shumë?

— Kushtojnë femrat, që i kanë sjellë nga jashtë. E kur ulen në prehrin e myshterinjeve, s'tunden gjersa gdhihet, a po s'ta rrëkellejnë shampanjën si ujin.

— Nga jashtë e kanë sjellë atë femrën e bukur?

— E re!

— Pse?

— Se të vendit nuk janë të ci-vi-li-zuara,

s'dinë tē pijnë shampanjë e uiski and soda si evropiankat. I thonë Shanuar këtu, dancing, domethënë dang-dang-napolonat.

— Tërë natën këtu rrinë?

— Shanuari vetëm natën punon, se ata që kanë verdhushka, ditën flenë, pasi, helbete, lodhen natën. Ikë, o vëlla, sa s'kanë ardhur tē garnizonit tē tē rrasin brenda; ikë se s'është vend përtty.

— Hej, dreq! — përshpëriti prapë Shabani i habitur dhe, si ngjeshi kapën gjer te veshët, mori udhën nga kazermat. — Si tha: «Dy franga ari vetëm kafeja!» Iu mbylltë dera, iu mbylltë. Të kem unë dhjetë lëkë, ngop barkun përpesë ditë, e çfarë tē ngopur se! — dhe ushtari shtrëngonte gjysmën e lekut që i kish mbetur në xhep.

— Ama femër!

Tiranë tē tillë kish parë kur pat bërë ushtrinë dhe pandehte se e njihte kryeqytetin. Potani që kërkonte punë e u binte rrugëve poshtë e përpjetë, ai pa një Tirana tjetër. Prapa dyqaneve lluksoze tē rrugës «28 Nëndori», te pazari i vjetër, njoju kryeqytetin e vërtetë. Pleq tē dobët e tē deformuar qëndronin pa lëvizur, si kufoma, me sytë mbyllur, po me veshët ngrehur përpjetë tē dëgjuar trokëllimën në kalldrëm tē ndonjë palë këpucëve me shollë. Burra me sy tē buhavitur, tē parrojtur e tē zymtë silleshin pa punë nëpër udhët e pazarit. Kur dëgjonin tē ecurit serbes tē ndonjerit apo trokëllimën e progjeve, ata dilnin në mes tē udhës. Sytë e venitur e tē skuqur tē pleqve merrnin jetë, e shpresë se mos nxirrin ndonjë lek u jepte gjallëri fytyrave tē tyre kock'e lëkurë.

— Kush vjen tē mbajë ca gurë?

Këto fjalë sikur ua pértritnin muskujt e tyre tē mpirë. Ata ngriheshin e bashkë me tē tjerët rréthonin zotérinë.

— Sa? — pyeste ky pa iu drejtuar asnjerit dhe shtonte: — Ka nja dy orë punë.

Të gjithë e dinin se ai gënjente, se gurët e tij kërkonin një ditë tē tërë pune, po nuk e zinin në gojë. Kryesorja qe se ai njeri paguante, jepte lekë pér tē blerë bukë.

— Pér katër lekë, vij unë, — hidhej njeri.

Të tjerët e shihnin me inat shokun e tyre e ndonjeri ia priste aty pér aty:

— Po vi unë pér tre lekë e gjysmë.

I pari vrejtej, murmuriste ndonjë tē sharë dhe ndukte zotérinë nga mënga.

— Ikim, zotéri; s'po prishemi në pazarllék. Më jep tre lekë.

Po zotnia s'fiste e s'luante nga vendi. Ai priste.

— Më merr mua pér dy lekë? — ndihej zëri i ndonjë fëmije që më kot kërkonte tē çante rréthin e tē papunëve e t'i afrohej zotërisë.

— Kam edhe karrocë.

— Këput qafën, këlysh kurve! — i çfrynte ai që ish më pranë, e i jepte një tē shtyrë.

Zotnia heshte e priste.

— Hajt, zotni, dy lekë e gjysëm.

— Dy lekë e një grosh e një copë bukë.

— Dy lekë e tē mos e zgjasim më. Më pak s'ka ku tē vejë.

Më në fund zotnia hapte gojën:

— Janë shumë pér pesë copë gurë, — e mat tej tē largohej.

Të papunët mërmëritnin e shtrëngoheshin më shumë rrötull tij.

— Dale, more zotni, sa thua ti?

— Shumë, — ngulte këmbë gjene ai e përpiquej të hapte udhë.

Të tjerët s'e linin të largohej.

— Folë edhe ti një fjalë. Si qenkan shumë dy lekë!

— Po të doni, — ish fjala e tij e fundit dhe nisej të ikte.

Zotnia futej nëpër udhët e shtrëmbra të pazarit të vjetër pa kthyer kryet pas. Ish i sigurtë se do gjente të papunë të tjerë, siç ish i sigurtë se ata që la pas do ta ndiqnin.

Edhe Shabani e pati pisk ato ditë. Më në fund me ndihmën e shokut të vjetër, Illos, mundi të gjejë punë në minierën e Priskës, që kish hapur një deputet nga jugu. Po edhe atje i polli belaja. Pronari s'paguante. E Shabanit i duhej të zbriste në Tiranë një herë në dy javë, të sorollatej ca pa mezi t'ia xhvatëtë lekët. E kërkonte deputetin në shtëpi, i thoshnin se kish dalë. Në Parlament nuk e linin të hyjë. E dinte që pasditeve deputeti mblidhej me miqtë e tij në kafe «Kursal». E priste te porta e kafenesë. Rrinte aty si hu gjer mbyllej lokali, po gjene nuk e zinte dot. Më vonë i ra hilesë. Shabani ruante derën e madhe, kurse deputeti ikte nga dericka e pasme. Atëherë zinte shtegun tek kjo derickë dhe përgjonte nga të çarat e grillave, gjersa mbaronte kumari. Deputeti loste në ca dhëma të vogla ku herë herë hynte një italiankë, që queshte ë përkëdhelej. Minatori ziente nga marazi. I vinte të thyente dritaret, të futej në dho-

mën e vogël e ta mbërtente deputetin për gryke:

— Pse s'më jep hakën, qen bir qeni, po lot kumar e argalishesh me kurva me lekët tonë?

Po herën e fundit pati vendosur të zihej keq. Gruaja i kish lindur ca muaj më parë dhe ai s'i kish dërguar asnje çerek leku.

Në qytet zbriti aty nga drekëhera. Ekte kokulur, duke menduar fjalët që do t'i thoshte zotnisë. Te xhamia e vjetër qëndroi. Nga sheshi i Bashkisë përhapeshin të thirrura sa tundej tërë Tirana.

— Ç'të jetë vallë? — mendoi dhe pa rrötull.

Njerëzit iu dukën ndryshe, ecnin shpejt, bërtisnin dhe shkonin nga bashkia. Dyqanet qenë mbyllur.

— Ç'është kështu? — pyeti njerin.

— Ron në këtë botë apo jo? — ia priti ky.

— Tërë vendi është ngritur më këmbë, kurse ti hala te ura.

— C'ka ngjarë, mor vëlla?

— Italia kërkon të pushtojë Shqipërinë.

— Si the?

Tjetri iku pa i dhënë përgjigje.

— E ç'i paska bërë Shqipëria Italisë që dashka ta zaptojë? Pa dale të shoh ç'bëhet?

S'kish bërë as dhjetë çapa, kur u dhanë në qiell ca aeroplanë të zinj, që gumëzhinin sa të shurdhonin.

— Qenka e vërtetë! — mendoi e iu kujtuan ca fjalë që pëshpëriteshin ato ditë për Italinë gjer në Priskë. Aeroplanët i shtinë frikën. S'kish parë aq shumë e do të ishte futur ne ndonjë qoshe, po të kish vënë re edhe të tjerët që të fshi-

heshin. Ca nga kjo, e ca nga inati që Italia donte të zaptonte Shqipërinë, vrapoi te sheshi. Atje, që mbledhur tërë Tirana, kërkonin armë, ngri-nin lart flamuret kuq e zi, këndonin «Për më-medhenë, pér mëmëdhenë». Iu njeth mishtë. Sikur t'i kishin dhënë armë, do shkonte edhe ai me ta... Tërë mbrëmja kaloi me demostrata. Të nesërmen Italianët zbritën në Durrës. Në Tiranë gjithë populli kish dalë nëpér udhë e kërkonte armë, donte të luftonte. Mbreti ia mbathi po atë ditë. Burgjet u hapën. U hapën edhe fjalë sikur do të bombardohej Tirana. Po ku donte t'ia dinte populli. Ndajnatëherë Shabani shkoi më ca të rinj prapa pallatit, tek një depo armësh. E çqyen. Gjetën ca kasa. I hapën e ç'të shohin: pushkë pa shule!

— Ptuu të marrtë djalli! — çfryu Shabani i inatosur. I erdhë inat me mbretin. Le që vetë s'ia mbajti të qëndronte me popullin e të luf-tonte, po armët pse i fshehu?

Atë mbrëmje disa hynë në pallat të Zogut e të princeshave e rrëmbyen ç'u zuri dora. Shabanit i vinte mëndja vërdallë. Bukë s'kish ngrënë që të djeshmen. I vajti mendja te deputeti.

— Atij kush e di si i zien koka pér Shqipërinë, e unë ta çqetësoj pér dy dollarë! — men-doi dhe ktheu udhën.

Kur u bë natë e njerëzit zunë të pérndahen ai s'dinte nga të vejë e ku të rrinte gjer të gdhi-hej.

Brodhi një copë herë posht' e përpjetë. Po i grryeren zorrët nga uria. Gjumi po e merrte, se natën e kaluar s'kish myllur sy.

— Do fle nën urë! — tha, duke parë urën e drunjtë të Lanës.

Zbriti atje. Vendi qe i ndyrë. Mezi rregulloi një kënd të pastër e ra si i kapitur. Po pa bërë as gjysmë ore gjumë u zgjua i lebetitur. Ndjente dhëmbje në këmbë. I dilte gjak. Minj, të mëdhenj sa një mace silleshin rrotull. S'donin t'ia dinin as nga njeriu, as nga gurët, që u shtinte. E kishin kafshuar keq. Doli nga nën ura me një opingë. Tjetrën ia kishin marrë minjtë. Ndenji një copë herë mbi bar anës Lanës. Tek-tuk rëpër Tiranë dëgjohej krisma e ndonjë pushke. Kish frikë të bridhte se mos hante ndonjë plumb e shkonte si qeni në vreshtë dhe s'luajti nga bari gjer sa u gdhi. S'qëndronte dot më këmbë. Me një gisht ta shtynin, do binte shakull përdhe. Zuri të ecë prapë nëpër udhët e shkreta. Kur lindi dielli u gjend pranë ca kopshtijeve.

— Le të bëhet ç'të bëhet — vendosi.

Hyri te njera syresh, u shtri në një vend të sheshtë me diell dhe e mundi gjumi menjëherë.

U zgjua kur kish kaluar dreka. Barku i qe ngjitur pas kurrizit e kaq boshllëk ndjente sa që i merreshin mëntë dhe ecte si i dehur. Te një rrugicë pa dy fëmijë me bukë e gjizë në dorë. Zuri t'i shkonte lëng nga goja. S'duroi dot më.

— Të gjithë bukën do ta hash? — e pyeti njerin.

— Pse, do pak ti?

— Po të duash, një copëzë të vogël!

— Merre, — dhe i dha gjysmën.

E hëngri si i babëzitur. Doli te ura nën pallatin e princeshave. Në rrugën e Elbasanit kish lëvizje të madhe. Shabani mbeti në vend i shastisur. Italianët kishin hyrë në Tiranë...

Majori ferkoi ballin i trondit tur nga kujtimet e së kaluarës, u ngrit nga trarët dhe u fut në magazinë. Kur veshi teshat prej gome të minatorit dhe hyri në galeri, zemra nisi t'i rrahë me forcë. **Ajri i ftohtë, gurgullima e ujit, era e rëndë si myk e dheut plot lagështirë i ngjallën rish-taz vitet kur ai futej në vrimat e iriqit.** Pa dashka u krrus e mbylli sytë përvjymë. Po disa çaste më vonë e drejtoi trupin. Galeria që aq e gjërë dhe e lartë sa ecnin lirisht tre vetë. As sytë s'kish pse t'i mbyllte përvjymë: llambat elektrike të vendosura anash e bënin galerinë ditë. Në mes shtriheshin shinat. Rrëzë armatura-ve me trarë të trashë e të dëndur kalonin tuba-cione të madhësive të ndryshme të ajrit të kom-presuar për pistoletat, të fijeve elektrike, të ujit. Vënde vënde tabela të mëdha u kujtonin mina-torëve rregullat e punës, si të mbroheshin nga ndonjë rrezik i papritur. Herë pas here dishen-deri të thella si puse lidhnin atë galeri me gale-ritë e tjera ose me fronte pune. Trasportatorë sillnin nga sipër e poshtë qymyrin e grumbu-luar nëpër këto galeri e fronte. Vënde-vënde, këtë punë të tansportatorëve e kryenin vetë va-gonat që zbrisnin e ngjiteshin me anë argane-llosh të fuqishëm.

Majori shihte i mahnitur. Sa kish ndryshuar miniera! Gjithë ajo maqineri në zemër të malit! Vagonat mbusheshin menjëherë, qymyri nxirrej me lehtësi në sasi të mëdha. Xhepat ta-ni qenë të gjëra, sa rrjinin disa njerëz. Shtresat e mineralit çfrytëzoheshin gjer në fund; mi-

nat me fitil, për të cilat kish dëgjuar, qenë zë-vëndësuar me mina me koreht, bilo po vendos-nin sharra prerëse. Dita ditës minatorët pris-nin pistoletat me korrent në vënd të atyre pneumatike dhe lopatat vetlevizëse...

Majori u drodh dhe zuri të marrë frymë thellë.

— U lodhët? — e pyeti tekniku.

— Jo! M'u kujtua diçka kur punoja në mieri.

— Punuat shumë vjet?

— Prej 1927 gjer në 1943.

— Paskeni qenë me Xha Ramën e me Nasin, Bëjmë pak anës, se po vinë vagonat, — e ndrroi ai fjalën.

Qëndruan nën driten e elektrikut dhe pri-tën. Nga kthesa e galerisë, pak më tutje, u dukën vagonat.

— Është qymyri i brigadës së Myrtos, — tha tekniku, duke parë blloqet e mineralit mbi vagonat.

— Është brigadë e mirë?

— Më e dalluara e rinisë. Tejkalon normën 112-120 përqind. Është në garë me brigadën e Xhoxhit.

— Kush ia kalon njeri tjetrë?

— Myrtua është nxënës i Xhoxhit. Mjeshtri e mbajti pranë vetes nja dy vjet dhe një ditë i tha drejtorit: «Urdhëro, shoku Zisi, një brigadier të mirë». Myrton e bënë përgjegjësin e brigadës së të rinjve. Ato ditë u bë një mbledhje për të marrë zotime. Ngrihet Xhoxhi dhe e ftion në garë Myrton. Myrtua u hutua. U hodh njeri e tha: Është si shpejt, o Xhoxhi ta vesh në se-

dër djalin. Ai sapo u bë brigadier, qysh tē matet menjéherë me ty? — Po Xhoxhi s'tundej nga e tija. E bën, e bën — ngulte këmbë dhe i kthehej Myrtos: — «Shiko mor djalë, nē s'do tē më turpërosh mua, mos u têrhiq se pastaj do thonë që s'kam punuar mirë me ty e s'kam -xjerrë brigadier pér tē qenë». E kështu u vunë nē garë. Venë pothuaj njälloj. Herë ia kalon njeri, herë tjetri. Ta shohim nē fund.

* * *

— Punë e mbarë, Xhoxhi!

Minatori çképuti pistoletén nga qymyrguri, fshiu fytyrën me mëngë dhe pa një çast majorin duke picërruar sytë.

— Bame!... Ku je vëlla!

Shokët e vjetër u qafuan e u puthën me mall.

Në fillim s'dinin ç'të thoshnin, pastaj fjalët u rrodhën si lumë. Kujtuan kohën kur punonin bashkë, qeshën, ngacmuan njeri tjetrin. E tekxa fliste Shabani s'ia ndante sytë pistoletës.

— Xhoxhi, a i mbush dōt tē njëqind okët?

— Mezi i mbush, — u përgjegj tjetri. — U plaka.

— Po këtë ç'e ke? — e ngacmoi major Shabani, duke i treguar pistolet-n. — S'e paske më kazmën e vjetër?

— M'u thye, o byrazer, e kush djall i del përpura Ibrahim Baçit. Tani më duhet tē mbledh ca lopka e tē blej një tjetër. Hëpërhë po punoj me këtë pistoletin pneumatik.

— I shkreti ti ç'të paska gjetur!... Kush e di sa vuani!...

Dhe qeshnin me gjithë zemër.

Muhabeti vijoi një copë herë. Kujtuan shumë gjëra. Çdo ngjarje u kujtonte të tjera ngjarje, emra e hollësira të harruara. Kujtuan kështu edhe grevën e vitit 1942. Ato ditë kishin qenë vendimtare për ta e s'do t'i harronin dot kurrë. Tekniku i ri sikur i thithët fjalët e tyre...

* * *

... Muajt e parë të atij viti posa kishin kaluar. Lufta e Italisë me grekun kish dëmtuar njerëzit, u kish prishur e çkatërruar mallë e gjënë. Jeta qe shtrenjtuar. Po pronarët e minierës s'donin të paguanin më shumë. Punëtorët mërziteshin, zemerohsin, grindeshin më shumë me Ismailin.

Atë vit Shabani qe kthyer rishtaz në minierën e Mborjes. Mezi e rregulloi që t'ia zbriste inatin kryepunëtorit. Veç tanë ai kish marrë forcë të reja. Të tjera mendime kishin nisur t'i zienin në kokë. Ish njohur në Korçë me një djallë. I pëlqente shumë të kuvendonte me te, se ai sikur të hapte sytë të shihje qartë. Fliste shtruar dhe vinte gishtin në plagë. I shpjegonte Shabanit, si të kish punuar vetë në minierë, se si p'onarët vidhnin e çfrytëzonin puntorët. Dhe Shabani shumë gjëra nisi t'i shohë lakuriq ashtu siç ishin, ndersa një zëmëratë e madhe zuri t'i vlojë në zemër. Ndërkohë pakënaqësija e minatoëve ndaj pronarëve po shtohej. Punëtorët flisnin me zë të lartë, s'donin t'ia dinin më për Ismailin dhe ia kthenin fjalën aty për aty. Trak-

stet e partisë, demostratat në Korçë, lajmet që vinnin nga Tirana, Durrësi, Vlora, Kuçova për atentatë, për përleshje me armiqjtë, për grevat, i bë-në më të guximshëm. Shabani i nxitte:

— Po të qëndrojmë të gjithë në një mëndje, s'kanë ç'të na bëjnë, — u thosh.

— E ku pyesin ata për ne, — hidhej ndonjeri, që ndruante. — Do të na përzënë e ku të mbytemi pastaj!

— Ja e zëmë se na përzunë. Me se do ta nxjerrin qymyrin?

— Pajtojnë të tjerë.

— S'u leverdis.

— Pse? Apo s'shitet më shtrenjë tanë qymri, apo s'kërkohet për qamet.

— Tamam! Prandaj edhe bukuroshët tanë kanë nevojë për minatorë të regjur, që të nxjerrin sa më shumë qymyr. Të pajtojnë punëtorë të rinj s'fitojnë gjë. Ibrahim me të tjerët s'ia kanë nganë të presin motmot sa të mësojnë punëtorët.

— Ashtu është: s'kanë ç'na bëjnë, po të jemi të bashkuar e ta mbajmë fjalën gjer në fund!

— Mirë e keni, xhanem po... po sikur të thonë jo?

— Po thanë ashtu, braktisim minierën. Kur të shohin se po ikim, do të na thérresin. E, si thoni?

— Ashtu të bëhet.

— Daleni, bre, mos u ngutni. Ta mendojmë edhe r. jë herë.

Kështu një ditë, minatorët zbritën në Korçë e shkuan në zyrat e shoqërisë. Atje i priti më i vogëli i Baçeve, Aliu, që përpiquej ta mbante

me zor zémërimin. Ibrahimi, i madhi, s'ndodhej në Korçë atë ditë. Kjo sikur u dha më shumë zémër nj'a dyve, që, gjer në minutën e fundit, mezi u bindën.

— Unë ju them t'i hiqni nga mendja këto budallallëqe, — ia pat që në fillim pronari. — Kthehuni në punë, se do merrni veten dhe fëmijët në qafë.

— Është gjynah të çqyhem pér tre lopka, pér një lek e pér dy lekë. Tani qomyri shitet më shtrenjtë. Çdo gjë është shtenjtar. Ne s'kërkçjmë shumë; katër lekë pér çdo njëqind okë qymyr,

— Cili ua ka futur këto spica? E dini se lajmëroj kuesturën t'ju rrasë brenda?

Minatorët rrinin të mvrejtur. Shabani kafshonte buzën. Me bisht të syrit shihte një «shok» nga ata të qytetit, që pak më tutje zyrës frynte gomën e biçikletës.

— Do tregoni apo jo? — çfryu Ali Baçi.

— Çfarë të tregojmë? — u hodh Rama.

— Kush ua ngriti mëndjen që të kërkoni katër lekë?

— Barku, fëmijët tanë që s'venë gjë në gjë mbrëmjeve, se s'na del, — iu përgjegj Shabani dhe e pa me inat. — Zotrote s'e ke ndjerë urinë, ndaj flet kaluar.

— Mbylle gojën! — u xhindos pronari.

— Pse ta mbyllë, — u hodh Xhemali. — Do na paguani katër lekë apo jo?

Aliu thirri, u tërbua, kërcënoi se do i fuste në burg si komunistë, po s'i dolli gjë. Minatorët as u trëmbën, as u tërhoqën. Dhe pronarit iu desh ta ulte zémërimin.

— Ju them edhe një herë pér të mirën tuaj.

Jo katër lekë që s'do merrni kurrën e kurrës, po asnjë lopkë më tepër. Në ju pëlqen mirë, në mos «shëndoshë manastiret, pa kallogjerë gjen kur të duash».

Gjer nga dita e dhjetë greva vajti mirë. Komiteti qarkor i qytetit i ndihmoi me të holla dhe ushqime që i mbloodi në popull. Shabani zbriste përditë në Korçë e herë tek një shtëpi, herë tek një tjetër, ku e dërgonte «shoku» me biçikletë, mblidhje qese me miell, kuti marmalate, makarona, oriz, shishe me vaj e të holla. Nganjëherë gjente dhe pak me paqeta «Diamant», «Tatlisert», «Morava». Kjo ndihmë i mallengjeu minatorët, i lidhi më shumë me njeri tjetrin, i bëri më të guximshëm e më të vendosur.

— S'e pandehja kështu, — fliste njeri.

— Morpo me këtë rast piva edhe «Morava» e «Tatlisert»!

E kur shihnin Shabanin e rrethonin.

— Si duken punët? Ç'thonë ata?

— Akoma s'kanë vendosur. Ibrahimë është bërë për t'u lidhur, shkumë nxjerr nga goja. Ai ngul këmbë që të mos shtojnë asnjë lopkë, bile, kërkoi ta rregullojë me kuesturën e me komandën italiane që të na marrin me zor, si të burgosur. Të tjerët s'duan. Ca janë gati të na shtojnë gjysmë leku. Po hahen si macja me minë.

Një shok i qarkorit i kish thënë Shabanit se shumë shumë një javë do rrinin pa punë, dhe pronarët do kërkonin vetë të binin në ujdi. Mirpo po mbusheshin dy javë, ndihmat po shteronin dhe ata të Shoqërisë s'po vendosnin akoma. Nja dy minatorët zunë të ankoheshin.

— Duroni. Puna ka mbetur më sot me nesër
— u jepte zemër Shabani.

— E sa do vazhdojë kjo «me sot me nesër»?

— Na mbetën fëmija pa bukë, ç'bëni kështu?

— Të gjithë keq jemi po durojmë — hidhej Thimi.

— Unë duroj, po barku s'ngopet më llafe, do mbushur.

Shabani nxehet, po e mbante veten.

As të nesërmen, ata s'u ndjenë. Shabani, i trondititur, brodhi tërë paraditen udhëve të Korçës, gjersa e gjeti shokun e biçikletës.

— Si të bëjmë or vëlla. Janë ca minatorë që kanë vendosur të kthehen në minierë. Duan të venë që sot në zyra e të marrin hua ndonjë lek, se kanë tërë ditën pa ngrënë.

— Mos, se ju fikën!

— I mbajtëm gjer sot, s'kemi ç'u bëjmë, veç t'i lidhim.

— Do na iki kot tërë kjo luftë. — Shoku u mendua një çast dhe kërkoi nëpër xhepat. — Merrri këto shtatë lekë. S'kam të tjera. Pas tri orësh eja te shtëpia e Kristaqit.

Shabani u kthyte te minatorët dhe u ndau lëkët punëtorëve. Pastaj ia mbathi nga shtëpia e tij.

— Nxire ca qesen me miell, — i tha s'ëmës.

— C'e do?

— Nxire se na duhet.

Plaka ia pruri nga ashefi.

— Kemi bukë për sonte?

— Ç'ke ndër mend të bësh? — i foli plaka e ngrysur.

— Moj, a kemi bukë për sonde?

— Kemi.

— Hiq nga qesja dy tase miell pér fëmijët.

— Do na lesh pa bukë fare, bir. Edhe pér dy ditë ka:

— Të tjerët s'kanë as pér sot, — iu përgjegj i biri dhe si hoqi dy tase, mori qesen dhe doli.

— Si do ja dalim, dreqi e merr vesh!.. — fliste më vete teksha shkonte të takohej me shokun.

— Tani vjen, — i thanë te shtëpia e Kris-taqit. — E prisni!

Shabanit s'i rrihej. Donte të kthehej tek minatorët. Kish frikë se mos ndonjerit i mbushej mendja e kthehej në punë.

«Si duket dolën më të fortë se ne ata qentë!.. Na e punuan!...» — mendoi.

Në dhomë hyri shoku.

— Ke shumë që pret?

— Kam ca. Gjete gjë pér ata?

— Pako gjë, — dhe zuri të qeshë: — Fituam, Shaban!

— Hë? — Shabani s'u besoi veshëve.

— Fituam, more, fituam! — dhe i shtrëngoi krahun: — Nesër në mëngjes do t'ju thërrasin. Kanë vendosur të shtojnë tri lopka... Tani pér tani pranojeni, se ata s'japin më tepër. Mos harroni se ata do të mundohen t'ju mbushin mendjen pér një lopkë. Ju ngulni këmbë në tuajën, gjersa ata të arrijnë në tre çerek leku. E zgjatën enkas që t'ju detyronin nga urija të ktheneshit përsëri.

Kjo fitore i dha krahë Shabanit. Por edhe minatorët tani i merrnin traktet me dëshirë dhe vinin rregullisht në mbledhjet që bëheshin herë pas here. Më kot pronarët u përpoqën t'i përcanin e t'i vinin në grindje me ç'u vinte ndoresh, si-

domos duke hédhur farën e dallimit ndërmjet «kaurëve të Drenovës» dhe myslymanëve.

Një ditë Ismaili lajmëroi ca «kaurë të Drenovës» që të mos vinin në punë. Në minierë u bë rrëmujë. Minatorët braktisën galeritë dhe u mblodhën përpara barakës së kryepunëtorit.

— Kështu ka vendosur Shoqëria, — mundohej t'i bindte Ismaili — S'i marrin njerëzit më senet që të punojnë tërë jetën këtu. Kur ka punë, bujrum; kur s'ka, s'ka.

— Ec' e u thuaj zotërinjve se dallaveret e tyre s'pijnë më ujë, — ia priti Shabani. — Po qe se përzenë Xhoxin, Thimin, Nasin e Ilon, do ikim të gjithë, që të gjithë, more vesh? ..

— Mor po Shoqëria është zot i minierës, apo ju?

— Ti shko e thuaj fjalën tonë. Këtë bëj! — iu përgjegj Rama.

— Si guxoni të futni hundët në punët e të tjerëve, si t'ish qymyri malli juaj?

— Mos u bëj merak, se i joni do bëhet, — u hodh Xhemali. — Po ti ku do futesh?

Minatorët zunë të qeshin. Ismaili u zverdh nga zemërimi.

— Ju paskan molepsur keq komunistët, — foli. — E ç'u kanë thënë tjetër, ë? Ju kanë thënë te sërisht me gratë e shoqi shoqit, t'i bëni gra motrat?

— Mbyll gojën, qen! — iu turr Shabani e i hipi gjaku në kokë nga këto fjalë. — Mos i zerë në gojë komunistët se ta bëra gropën.

Të tjerët e mbajtën.

— Ç'ia ve veshin dreqit, — kërkonin ta qetësonin dhe e larguan pak më tutje.

Po Ismaili s'pushonte dhe fliste duke treguar Shabanin, që po rrinte i ngrysur.

— E shikoni atë kuqon? Kur ju vuanit për bukë ato ditë që muartë ment e tij e latë punën, ai e mbushte barkun me gjithë të mirat me paratë që i vinë nga Rusia. Do ta shohë të s'ëmës ai, po ju, or mëndjelehtë ku u shpie mushka?...

Xhemali qe nxirë në fytyrë dhe shikonte shtrëmbër kryepunëtorin, që vijonte:

— Ne s'duam t'ju bëjmë keq, pa dimë si të sillemi. Që nesër biem kuesturën dhe ua ndreqim samarin. Në daçi pastaj mos i lini të shkojnë ata që u pushuan. Ndaj mblidhni mëntë e shkoni në punë.

Minatorët zunë të shpérndahen. Vetëm Xhemali s'lojti nga vendi. Kur para barakës s'kishin mbetur as tre veta, ai hyri brenda dhe pa thënë asnjë fjalë, e mbërtheu Ismailin për fyti.

— I ke parë ti komunistët të ndërrojnë gratë me shoshoqin? — i bërtiti.

— Ç'bën kështu, hiq duart!

— Mor këtu, më thuaj, i ke parë?

— Hiq duart se do ta pësosh keq!

— Do përgjigjesh apo jo?

— Po unë s'kam gjë më ty, Xhemo...

— Po me cilin e ke?

— Me... me komunistët.

— Ashtu, hë! Ja unë jam komunist, — dhe zuri t'i bjerë në fytyrë me grushta, pastaj e shtriu përdhe dhe e zhëdëpi mirë.

Atë natë, Shabani dhe Xhemali u takuan të shtëpia e një fshatari.

— Do ikim ndaj të gdhirë?

— Po.

— Lajmërove në Korçë?

— Po, po. Çeta e Devollit është në Bradvicë.

— Pritmë te bregu sipër.

— Mirë.

Shabani u kthye në shtëpi pas mezit të natës.
Pleqtë dhe e shoqja e shikuan pa folur.

— Do t'u ndihmojnë shokët me ndonjë ushqim, — i tha plakut.

I ati heshtte.

— Të kujtohet q'më the atëhere kur ma punoi Ismaili? — iu kthye Shabani duke vënë buzën në gaz.

— S'e mbaj mend.

— Ikë në mal, dil kaçak, s'më the?

— Po, kështu të thashë!

— Tani erdhi koha që të dal në mal.

— E shoh, e shoh. Dalçi faqebardhë, bir, dhe po të më dëgjoni mua mos u ktheni pa e çfarosur tërë këtë farë të mallkuar. Digjeni nga rrënjet që të mos mbijë më kurrë.

Kur mbeti disa çaste vetëm me të shoqen e me të dy fëmijët që flinin, nuk dinte q'të thosh. I vinte keq për Resminë e për Lumkën e vogël. U ul e i puthi në gjumë

— Mos u mërzit, — i pëshpëriti së shoqes që qante. — Ki besim në ato që të kam thënë. Do rrojmë ndryshe kur të fitojmë.

— Po minierën ç'do ta bëni?

— Do jetë jona.

— Mbyllini më mirë të tëra minierat.

— Pse?

— Mjaft rrojtëm me ankth.

— S'më kuptove. Minierat do jenë tonat.

— E di, e di, po ankthiin tonë që do ju presim pér natë me zemër të ngrirë...

— Jo, moj e gjorë, s'do jetë më ashtu si sot.

Të nesërmen Shabani me Xhemalin qenë në çetën e Devollit. Nga kodrat poshtë Bradvicës ai soditi një copë herë luginën e minierës, atë luginen të vogël me brigje të xhveshur që e lau me djersë pér gjashtëmbëdhjetë vjet. Se si do ishin në minierë kur të fitonin, ai s'e dinte me hollësi; dinte vetëm se ajo do ish e minatorëve, e punëtorëve, e popullit, siç do ishin të gjitha minierat, i gjithë vendi. Ish i sigurtë se s'do vuante më as ai as të tjerët, se s'do t'i vdisnin njerëzit nga skamja e ethet, se s'do rronin më me frikën e papunësisë e më pasigurinë pér të nesërmen. Fëmijët do vishezin e do mbatheshin, do vinin në shkollë e do rronin si njerëz. Dhe pér këto do luftonte ai...

IX

— Shkojmë? — tha Xhoxhi.

Majori u ngrit.

— Të mbajta një copë herë pa punë, — i tha shokut të tij të vjetër.

— Unë mbarova që qëpari, po rregullova vendin pér brigadën e turnit tjetër. Bame, sot pas dite do vish me ne.

— Ku?

— Do ia shtrojmë te Dajlani.

— Pse?

— I lindi djalë. E ka fëmijën e dhjetë. Dje i dolli e shoqja nga materniteti. Do marrë një thes me para — Xhoxhi qeshi. — Djall Dajlani, s'i le

të tijat. Kur i thanë se do dekorojnë të shoqen me që të dhjetë fëmijët i ka të gjallë, ia priti: «Edhe këta çoc i ka gjetur një punë; për femrat e vrasin mendjen më tepër. Ç'ma dekorojnë atë, apo që të ma mbledhë më shumë! Mua, or mua duhet të më japid...» «Pse ty, o Dajlan, e ngacmoi drejtori. Apo se tani në pleqëri po bën më shumë fëmijë se kur ishe i ri». «Posi! Kollaj të duket të tejkalosh normën edhe në minerë edhe në shtëpi?»

Kur dolli nga galeria, Shabanit iu duk vetja minator. E hidhte çapin rëndë-rëndë, ndjente në fytyrë pluhurin e qymyrit e ngazëllimi i ziente përbrenda. Pistoletin e Xoxhit s'e lëshonte nga dora. Si të tjerët edhe ai përpëliti sytë nga dielli i fortë, fshiu ballin e djersitur me mëngën e xhaketës, qëndroi përpara tabelës së realizimit të planit ditor të sektorit ku qe futur dhe mbeti një copë herë duke këmbyer mendime me shokët përpara një vagoni me qymyr. Banjën e bëri bashkë me ta. Po kur veshi përsëri uniformën ushtarake ndjeu të ndrydhur në gjoks. Iu duk se i humbi shokët e tij të vjetër dhe gazi i brendëshem iu shua. Nga salla e dushit doli i fundit dhe deshi të shkonte vetëm nga drejtoria që të përshëndetet me ta. Po minatorët e morën me vete në mensë dhe e vunë në mes.

— E, Bame, — i tha Thimi, — si të duket miniera?

Shabani nuk e hapi gojën. Nofullat iu mbërtyn dhe një si kotkë iu bë në grykë. Tundi vetëm kryet.

— ... Dhe këta, — vijoi Thimi, — më plasën së thëni: dil në pension, çlodhu se ke një jetë të tërë që po kalbesh së gjalli nën dhe.

— Mirë të themi, xha Thimi, — u hodh një inxhinjer.

— E, ore, sa të më punojnë duart e këmbët, s'e lëshoj pistoletën, veç në më dhënçin ndonjë më të lehtë. Pastaj, kur të më thahen këto të shkreta do zë qoshen e bunkerit e do mbaj sehir kamionat që mbushen. Të duket kollaj t'i thuash tjetrit ikë nga miniera. Po s'është ashtu për atë që e ka vaditur çdo galeri me gjak e djersë. Ti je i ri, mor djalë dhe s'e kuption, po pa pyet Bamen, se ai këtu, tek copat e qymyrit ka shkrirë të ritë e tij.

— Kështu është, — ia pati Rama, — Ç'ka se plakës sime i është mbushur mendja se ne na ka magjepsur e bucura e dheut në bark të malit.

Shabani nuk fliste. Kur u ngrit mërmëriti:

— Si do ia mbush mendjen asaj. Do më kup-tojë, vallë, edhe këtë herë?

TRYEZA E LËNDËS

	Faqe
Trimat nuk vdesin	3
Fletë nga një ditar i vjetër kujtimesh	12
Ai i bankës së fundit	18
Infermierja	27
Jetëshkrimi i një minatori	38

JANE

Letërsi arti

Autorë shqiptar

	Lekë
G. Dara (I Riu)	— Kënga e sprasme e Balës
Migjeni	— Veprat
Z. Serembe	— Vjerrsha
Q. Stafa	— Qortimet e vjeshtës
Dh. S. Shuteriqi	— Këngë
Ll. Siliqi	— Këngë entuziaste
Q. Buxheli	— Një ndodhi në plazh
R. Brahimi	— Katër vajza
A. Allani	— Shqipëria kryesonjë
H. Petrela	— Të munduarit
Autorë të ndryshëm	— Këngë për dritën leniniste
Xh. Bilbili	— Skena dhe prapaskena
Autorë të ndryshëm	— Këngët e rinisë
R. Nepravishta	— Pelikanët ndrojnë fole
K. Dushi	— Kronikë e vëndit tim
N. Prifti	— Tregime
Gj. Zhei	— Ngjarje në Çajup
A. Cerga	— Njeri i zakonshëm